



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

**PROVIMI I SHTETIT**

**FONDI I PYETJEVE PËR PROFESIONIN E  
RREGULLUAR TË FIZIOTERAPISTIT**

**1. Moduli Bazat e Mjekësisë Fizike dhe Rehabilituese**

1. Mjekësia fizike dhe rehabilituese filloi të ngrihej si shkencë e mirëfilltë:

- A) që në kohën e Hipokratit
- B) pas luftës së parë botërore
- C) pas luftës së dytë botërore
- D) pas luftës së ftohtë

2. Fjala deficiente në rehabilitim do të thotë:

- A) mungesë të një gjymtyre
- B) prapambetje mendore
- C) prapambetje në zhvillim psikomotor
- D) mungesë të një strukture anatomike apo funksioni

3. Dokumentimi në rehabilitim:

- A) ruhet vetëm në raste të veçanta
- B) ka vlera etike dhe morale
- C) ka rëndësi në shumë aspekte dhe është detyrueshëm
- D) nuk ka vlera ligjore të mirefillta

4. Handicap në rehabilitim do të thotë:

- A) person me deficiencë trupore
- B) person me deficiencë mendore
- C) person me vështirësi në inserimin social
- D) person i kartelizuar

5. Klasifikimi ndërkombëtar që përdoret sot në rehabilitim është:

- A) I.C.F
- B) U.C.F
- C) I.C.D.I
- D) I.C.D

6. Objektivat e procesit të fizioterapisë duhet të jenë:

- A) reale, funksionale, të pandryshueshme
- B) reale, funksionale, të ndryshueshme
- C) madhore, sekondare, reale
- D) madhore, sekondare, të pandryshueshme

7. Mjekësia fizike dhe rehabilituese gjen aplikim:

- A) në nivel parësor, ambulatorial dhe komunitar të shërbimeve mjekësore
- B) në nivel dytëror, spitalor dhe komunitar të shërbimeve mjekësore
- C) në nivel parësor, dytësor dhe terciar të shërbimeve mjekësore
- D) në nivel dytësor, terciar dhe territorial të shërbimeve mjekësore

8. Nje paraplegjiku nuk i është ofruar një karrocë me rrota, kjo është:

- A) një handicap
- B) një pengese
- C) një defiçit ligjor
- D) një diskriminim racial

9. Fizioterapisti në ushtrimin e profesionit të tij nuk mund të:

- A) kryej ndërhyrje invazive
- B) përdori modalitetet fizike
- C) trajtoj pacient onkologjik
- D) të bëj rehabilitim postkirurgjikal

10. Fizioterapisti gjatë programimin të një protokollit rehabilitimi duhet të bazohet në radhë të parë:

- A) në eksperiencen personale
- B) në studimet shkencore mbi atë sëmundje
- C) në guide lines
- D) tek terapia mjekësore

11. Proçesi i fizioterapisë fillon gjithmonë me:

- A) trajtimin e pacientit
- B) vlerësimin e pacientit
- C) përcaktimin e objektivave
- D) vendosjen e djagnozës

12. Gjatë trajtimit fizioterapisti duhet gjithmonë:

- A) të mos ta lodhi pacientin
- B) të mos tejkalojë asnjëherë orarin e trajtimit
- C) ta bëjë pjesë aktive të trajtimit pacientin sa herë që është e mundur

D) të ketë parasysh që pacienti është një objekt

13. Rehabilitimi i pacientit është:

- A) është punë individuale e fizioterapistit
- B) është proces pasiv
- C) është pjesë e riaftësimit të pacientit
- D) është punë ekipore

14. Mjekësia fizike dhe rehabilituese i bën pacientit një qasje:

- A) biomjekësore pacientit
- B) individuale
- C) olistike
- D) mjekësore

15. Mjekësia fizike dhe rehabilituese ka si objektiv:

- A) integrimin e pacientit
- B) protezimin e pacientit
- C) izolimin e pacientit
- D) heqjen e barrierave arkitektonike

16. Tek një i sëmurë me astem pulmonare fizioterapisti mat frekuencën respiratore:

- A) në fillim të trajtimit rehabilitues
- B) në fund të trajtimit rehabilitues
- C) përpara dhe pas çdo trajtimi
- D) varet nga gjendja e pacientit

17. Në gradën 3 të testigur muskular muskuli është në gjëndje:

- A) të munda rezistencën e terapistit dhe gravitetin
- B) të munda vetëm resistencën
- C) të munda vetëm gravitetin
- D) thjesht të kontraktohet

18. Shkalla E.V.A përdoret:

- A) për vlerësimin e amplitudes artukulare
- B) për vlerësimin subjektiv të dhimbjes
- C) për vlerësimin objektiv të dhimbjes
- D) për vlerësimin e parametrave vitale

19. Forca muskulare e muskulit gluteal maximus vlerësohet:

- A) në pozicion ulur
- B) në pozicion dekubitur lateral
- C) në pozicion pron
- D) në pozicion supin

20. Vlerësimi postural i pacientit bëhet:

- A) në tre plane

- B) në katër plane
- C) në pesë plane
- D) në gjashtë plane

21. Valgjizmi patologjik i gjurit është devijim në planin:

- A) frontal
- B) sagital
- C) horizontal
- D) perpendicular

22. Goniometri shërben për të matur

- A) R.O.M artikular
- B) presionin e gjakut
- C) forcën e muskujve
- D) indin dhjamor subkutan

23. Gjatësia e muskujve matet me:

- A) metër shirit
- B) goniometër
- C) me gradë artikulare
- D) me sy të lirë

24. Forca muskulare matet me testingun muscular që ka:

- A) 2 grade
- B) 3 grade
- C) 4 grade
- D) 5 grade

25. Vlerësimi postural i pacientit:

- A) realizohet vetëm me sy të lirë
- B) realizohet vetëm i kompiuterizuar
- C) me sy të lirë dhe i kompiuterizuar
- D) nuk ka standarte e zgjedh vet pacienti

26. Biometria studion:

- A) ndërtimin morfostatik të trupit të njeriut
- B) ndërtimin morfodinamik të trupit të njeriut
- C) ndërtimin strukturor të trupit të njeriut
- D) ndërtimin muskolor të trupit të njeriut

27. Kineziterapia është terapi:

- A) e zbuluar nga kinezet që në mesjetë
- B) e lëvizjes
- C) zëvendësuese e masoterapisë
- D) që ka shumë kundërindikime në reumatologji

28. Zgjatja muskulare:  
A) duhet bërë gjithmonë në fund të seancës së rehabilitimit  
B) mund të çojë në këputje të fibrave muskulare gjithmone  
C) është teknike rehabilitimi  
D) duhet të zgjasë të paktën 30 min

29. KABAT është teknike:  
A) korrigjimi postural  
B) rehabilitimi kardiak  
C) që nuk përdoret më në rehabilitim  
D) qe përdor gjithmonë skema djagonale

30. Bobath është teknike:  
A) respiratore  
B) korrigjimi postural  
C) neurorehabilitimi  
D) kirurgjikale

31. Frymëmarja me diafragmë është teknike:  
A) drenimi  
B) masazhi  
C) relaksimi  
D) rinfocimi

32. Masazhi klasik ka:  
A) 5 teknika bazë  
B) 7 teknika bazë  
C) 8 teknika bazë  
D) 9 ternika bazë

33. Drenimi postural është:  
A) teknik vlerësimi postural  
B) pjesë e fizioterapise respiratore  
C) teknik trajtimi postural  
D) pjesë e posturalogjise

34. Bëjnë pjesë në teknikat e trajtimit të pacientit:  
A) testing muskular  
B) prova e efortit  
C) frymemarja me diafragme  
D) ROM-I artikular

35. Trajtimi i linfedemes bëhet me:  
A) diuretike  
B) me masazh klasik  
C) me linfoderazh

D) me limfadenektomi

36. Fizioterapist nuk e trajton dhimbjen:

A) me terapi manuale

B) me kineziterapi

C) medikamente

D) me teknika speciale

## 2. Kineziologji

1. Muskujt që sheshojnë lordozën lumbare janë:

A) muskuli iliak dhe psoas

B) muskuj ekstensor të shpinës

C) muskujt abdominal

D) muskujt flektorë lateral të belit

2. Muskujt rrotullues të shpinës gjatë kontraktimit të tyre bazohen:

A) në parimin e çikrikut

B) në parimin e levës

C) në parimin e rrotës

D) në parimin e Arkimedit

3. Tensioni i muskujve skeletikë kontrollohet nga motoneuronet:

A) alfa

B) beta

C) gama

D) delta

4. Muskujt agoniste janë muskujt

A) që pengojnë levizjen

B) që fiksojnë levizjen

C) që kryejnë levizjen

D) që ndihmojnë levizjen

5. Abuksioni është lëvizje që:

A) largon segmentin nga boshti i simetrisë

B) afron segmentin me boshtin e simetrisë së trupit

C) rrotullon segmentin rreth boshtit të simetrisë

D) përkul segmentin rreth boshtit të simetrisë

6. Kompleksi artikular i supit përbehet nga:

A) 3 artikulacione

B) 4 artikulacione

C) 5 artikulacione

D) 6 artikulacione

7. Stabiliteti supit sigurohet nga:

- A) muskujt e shpinës
- B) nga periartikular
- C) nga presioni atmosferik
- D) nga menisqet

8. Artikulacioni skapulo-humeral është artikulacion i tipit:

- A) selar
- B) cilindrik
- C) enartroze
- D) ellipsoid

9. Ekstensioni i parakrahut mbi krahun kryhet nga:

- A) muskuli koroko-brakial
- B) muskuli biceps brachial
- C) muskuli brakial
- D) muskuli triceps brakial

10. Kockat karpale janë të vendosura në

- A) 2 rreshta
- B) 3 rreshta
- C) 4 rreshta
- D) 5 rreshta

11. Tuneli karpal ndodhet

- A) tek bryli
- B) tek parakrahu
- C) tek kyçi i dorës
- D) tek supi

12. Shtylla kurrizore në dorë paraqet

- A) 2 kifoza
- B) 2 hiperkifoza
- C) 3 kifoza
- D) 3 hiperkifoza

13. Artikulacioni kokso-femoral:

- A) është artikulacion shumë stabil
- B) është artikulacion shumë pak stabil
- C) është artikulacion i palevizshëm
- D) është artikulacion gjysëm i levizshëm

14. Hernia diskale është më e shpeshtë në regjionin

- A) sakral
- B) koksigeal
- C) dorsal

D) lombar

15. Frymëmarja tek femrat është:

- A) abdominale
- B) torakale
- C) torako-abdominale
- D) cervikale

16. Disku intervertebral tek nje person 20 vjeç përbehët nga:

- A) 20% uje
- B) 40% uje
- C) 60% uje
- D) 80% uje

17. Disku intervertebral është më i fryre:

- A) në mëngjes
- B) në dreke
- C) mbasdite
- D) në darkë

18. Muskujt që thellojnë lordozën lumbare janë:

- A) muskujt gluteal
- B) muskujt kuadrat lumbar
- C) muskujt ekstensore te shpines
- D) muskujt abdominal

19. Muskujt pelvi trokanterik janë muskuj

- A) muskuj ekstrarrotullues të artikulacionit kokso-femoral
- B) muskuj intrarrotullues të artikulacionit kokso-femoral
- C) muskuj abduktor të artikulacionit kokso-femoral
- D) muskuj aduktor të artikulacionit kokso-femoral

20. Presioni atmosferik ndikon tek artikulacioni kokso-femoral:

- A) në uljen e stabilitetit
- B) në rritjen e stabilitetit
- C) në rrotullimin e kokes femorale
- D) në rritjen e presionit intrartikular

21. Normalisht legeni i njeriut është

- A) fleksion
- B) ekstension
- C) anteroversion
- D) retroversion

22. Legeni përbehët nga

- A) 3 kocka



- B) 4 kocka
- C) 5 kocka
- D) 6 kocka

23. Në grupin e muskujve stabilizues të artikulacionit kokso-femoral futen:

- A) muskujt pelvi-trokanterik
- B) muskujt ischio-krural
- C) muskujt femoral
- D) muskujt tibiale

24. Artikulacioni i gjurit falë prezencës së patelës funksionon si një:

- A) lev e llojit të parë
- B) lev llojit të dytë
- C) si një çikrik
- D) si një rrotë

25. Sheshimi i lordozës lombare bëhet:

- A) duke kontaktuar muskujt inklinues të shpinës
- B) duke kontraktuar muskulin ileopsoas
- C) duke kontraktuar ekstensoret e shpinës
- D) duke kontraktuar muskujt abdominal

26. Neurotranzmetitori i plakes neuro-muskulare është:

- A) adrenalina
- B) noradrenalina
- C) serotonina
- D) acetilkolina

27. Abduksioni i krahut kryhet:

- A) në plan frontal
- B) në plan sagital
- C) në plan horizontal
- D) në plan perpendicular

28. Hiperkifoza torakale është:

- A) përkuļje fiziologjike e shtyllës kurrizore
- B) përkuļje patologjike e shtyllës kurrizore
- C) përkuļje laterale e shtyllës kurrizore
- D) prezente vetem në adoleshence

29. Kendi diafizar i inklinimit të femurit formohet midis:

- A) diafizës femorale dhe asaj tibiale
- B) diafizës femorale dhe qafës femorale
- C) qafës femorale dhe kockave të legenit
- D) diafizës femorale dhe kockave të legenit

30. Këndi i deklinimit femoral formohet midis:
- A) qafës së femurit dhe planit horizontal
  - B) qafës së femurit dhe planit sagital
  - C) qafës së femurit dhe frontal
  - D) diafizës së femurit dhe planit frontal
31. Pozicioni këmbë mbi këmbë është:
- A) pozicion jo stable për artikulacionin skapulo-humoral
  - B) pozicion stable për artikulacionin skapulo-humoral
  - C) pozicion stable për artikulacionin kokso-femoral
  - D) pozicion jo stable për artikulacionin kokso-femoral
32. Disku intervertebral ushqehet:
- A) vetem me proteina
  - B) vetem me aminoacide
  - C) vetem me polisakaride
  - D) me difuzion
33. Mbajtja e stilolapsit në dorë realizohet nëpërmjet një prezë:
- A) pincore
  - B) interdigjitale
  - C) me opozicion suterminal të gishtave
  - D) palmare
34. Mbajtja e shishes realizohet nëpërmjet një preze:
- A) palmare të plotë
  - B) interdigitale
  - C) subtermodigitale
  - D) e vogël
35. Kineziologjia:
- A) është terapi e lëvizjes së tokë
  - B) është terapi e lëvizjes së ujë
  - C) studion lëvizjet e trupit të njeriut
  - D) studion strukturën e trupit të njeriut
36. Muskujt antigravitare që forcohen te paret tek femija janë:
- A) muskujt flektore të qafës
  - B) muskujt ekstensore të qafës
  - C) muskujt flektore të shpinës
  - D) muskujt ekstensore të shpinës
37. Muskujt e gishtit të madh të dorës janë muskujt të:
- A) eminencës hypotenare
  - B) eminencës tenare
  - C) eminencës mediale

D) eminencës laterale

38. Arkitektra normale e shputës së këmbës të njeriut përmban:

- A) 1 hark
- B) 2 harqe
- C) 3 harqe
- D) 4 harqe

39. Muskuli triceps sural:

- A) sheshon harkun medial të këmbës
- B) thellon harkun medial të këmbës
- C) sheshon harkun lateral të këmbës
- D) thellon harkun lateral të këmbës

40. Njeriu ecën në majë të gishtave falë kontaktimit të muskulit:

- A) tibial anterior
- B) tibial posterior
- C) triceps sural
- D) triceps femoral

41. Muskujt aduktorë ndodhen:

- A) në pjesën mediale të kofshës
- B) në pjesën laterale të kofshës
- C) në pjesën anteriore të kofshës
- D) në pjesën posteriore të kofshës

42. Muskujt gluteal janë muskuj:

- A) antigrauitar dhe ekstensor të artikulacionit kokso-femoral
- B) ekstensor dhe flektor të artikulacionit kokso-femoral
- C) flektor dhe intrarrotullues të artikulacionit kokso-femoral
- D) aduktor dhe intrarrotullues të artikulacionit sakro-iliak

43. Kocka kalkaneale:

- A) bën pjesë në kockat karpale
- B) bën pjesë në kockat tarsale
- C) bën pjesë në kockat metakarpale
- D) bën pjesë në kockat metatarsale

44. Ecja e njeriut ka:

- A) 2 faza
- B) 4 faza
- C) 6 faza
- D) 8 faza

45. Shputa e këmbës kur merr kontakt me terrenin:

- A) përshtat formën

- B) e ndryshon formën në mënyrë permanente
- C) pëson riorientim kockor
- D) pëson riorientim muskular

46. Shtylla kurrizore në pjesën lombo-sakrale:

- A) është shumë delikate
- B) është shumë e fortë
- C) paraqet kifoze
- D) paraqet lordoze

47. Përkulja e parë që formon shtylla kurrizore e njeriut gjatë zhvillimit intrauterin është:

- A) kifoza
- B) lordoza
- C) hiperkifoza
- D) hiperlordoza

48. Gjuri është artikulacion me:

- A) me një gradë lirie
- B) me dy gradë lirie
- C) me tre gradë lirie
- D) me katër gradë lirie

49. Muskujt e minencës hypotenare janë muskuj:

- A) motor të gishtit të madh
- B) motor të gishtit të vogël
- C) motor të gishtit të dytë
- D) motor të gishtit të tretë

### **3. Modalitetet e Terapisë Fizike**

1. Terapia me rreze ultraviolette përdoret në pacientët me:

- A) tendinit të muskulit biceps në fazën akute
- B) ne traumat e freskëta
- C) ne limfedemat e komplikuar
- D) ne patologjitë degjenerative në fazën kronike

2. Pas një aksidenti në shtëpi një fëmijë ka pësuar një traum kontuzive në rregonin gluteal. Çfare modaliteti duhet të përdoret menjëherë pas traumës:

- A) termoterapi endogjene
- B) terapi me ultratinguj
- C) krioterapi
- D) markoniterapi

3. Cila frequence e ultratingujve është më penetruese në inde:

- A) 1 MHz
- B) 2 MHz

- C) 3 MHz
- D) 4 MHz

4. Manjeto terapia është:

- A) elektroterapi e kombinuar
- B) elektroterapi direkte
- C) elektroterapi indirekte
- D) elektroterapi me fushë të gjerë

5. Terapi me mikrovale quhet ndryshe:

- A) markoniterapi
- B) terapi ne furë të nxehtë
- C) tekarterapi
- D) radarterapi

6. Modalitetet e terapisë fizike:

- A) janë pjesë e kineziterapisë
- B) janë pjesë e hidrokineziterapisë
- C) janë terapi hyrëse në rehabilitim
- D) janë terapi zëvendësuese të kineziterapisë

7. Elektrostimulimi është terapi fizike që përdoret për të stimuluar:

- A) muskulin e inervuar dhe nervat periferike
- B) muskulin e denervuar dhe nervat periferike
- C) muskulin e inervuar dhe muskulin e denervuar
- D) nervat periferike dhe palcën e kurrizit

8. T.E.N.S është terapi antalgjike që e ul dhimbjen nëpërmjet:

- A) stimulimit të prodhimit të dopamines
- B) nëpërmjet sistemit të kontrollit te portës në palcën e kurrizit
- C) nëpërmjet bllokimit të impulsive në fibrat nervore me kaliber të madh
- D) nëpërmjet shtimit të impulsive në fibrat nervore me kaliber të vogel

9. Lazerterapia në rehabilitim nuk aplikohet:

- A) me kontakt direkt
- B) me skanim
- C) në herpës simpleks
- D) direkt në sy

10. Sipas parimit të Arkimedit trupi i zhytur në një teren ujor

- A) peshon më shumë
- B) peshon më pak
- C) nuk i ndryshon pesha
- D) pëson deformime të formës

11. Në tendinitin e kalçifikuar modaliteti i tepapise fizike më efikas është:

- A) krioterapia
- B) ultratigujt
- C) lazerterapia
- D) T.E.N.S

12. Presoterapia është terapi:

- A) kundër dhimbjes
- B) kundër limfedemes
- C) kundër kalçifikimeve
- D) kundër hemoragjise

13. Hidrokinezi terapia gjen kunderindikacion absolute në:

- A) hemiplegji
- B) paraplegji
- C) spondiloartroze
- D) në dermatitin purulent

14. Thellesia e penetrimit të termoterapise me kontakt direkt është:

- A) 1 cm
- B) 3 cm
- C) 5 cm
- D) 10 cm

15. Përpara fillimit të seances së rehabilitimit me një pacient me hemiplegji rekomandohet:

- A) banjë me ujë të ngrohtë
- B) banjë me parafinë
- C) banjë me ujë të ftohtë
- D) banjë me hidromasazh

16. Terapia me rreze ultraviolete indikohet në:

- A) pelagra
- B) lupusin eritematoz
- C) sarkoidoze
- D) akne

17. Terapia me rreze ultraviolete kunderindikohet në:

- A) mundesën e vitamines D
- B) sinuzit
- C) psoriazis
- D) hipertiroidizem

18. Doza eritematoze minimale mat:

- A) nxirjen e lëkurës
- B) sensibilitetin e lëkurës
- C) nivelin e djegjes së lëkurës
- D) thellësinë e penetrimit të rrezeve ultraviolet.

19. Ultratingujt në rehabilitim përveç efektit antalgjik i përdorim dhe për efektin:

- A) nxirës të lëkurës
- B) termik
- C) masazhues
- D) stimulim të nervave

20. Akulli në qoftë se vendoset direkt në lëkure jep:

- A) vazodilatacion
- B) rritje të permeabilitetit kapilar
- C) zbehje të lëkurës
- D) djegje

21. Modaliteti me efikas i përdorimit të lazerit në fizioterapi është:

- A) me kontakt direkt me lekurën
- B) 20 cm larg trupit
- C) 50 cm larg trupit
- D) me oshilim

22. Në shtatzani mund të përdoren vetëm këto modalitete:

- A) laser dhe jonoforeze
- B) T.E.N.S dhe presoterapi
- C) manjetoterapi dhe mikrovale
- D) diatermi dhe lazer

23. Terapia me ultratinguj gjen indikacion në

- A) tumore
- B) osteoporozë
- C) limfedemen me fibroze
- D) në bursit të kalçifikuar

24. T.E.N.S është shkurtime i fjalës:

- A) stimuli nervor elektrik transkutan
- B) stimuli nervor elektrik me energji
- C) terapi e nervave sipërfaqësor
- D) terapi e nën sipërfaqshme

25. Llampat me rreze ultraviolet bëjnë pjesë në:

- A) termo terapinë me kunduksion
- B) termoterapinë me konveksion
- C) termoterapinë me skanim
- D) termoterapinë me rrezatim

26. Banjot kontraste gjejnë indikacion:

- A) në distrofie muskuale
- B) në infarkt të miokardit

- C) në vaskulopatite periferike
- D) artritin rheumatoid

27. Jonoforeza është modalitet terapeutik që realizon:

- A) përshpejtimin e medikamenteve me anë të fushës manjetike
- B) përshpejtimin e medikamenteve me anë të rrymës elektrike të alternative
- C) përshpejtimin medikamenteve me anë të vibrimeve akustike
- D) përshpejtimin e medikamenteve me anë të rrymës elektrike të vazhduar

28. Lazerterapi nuk gjen kunderidikacion absolute në:

- A) në tre muaj e parë të shtatzanise
- B) në karcinomën mamare
- C) në zonën hemoragjike
- D) në plagët e shtratit

29. Tufa e rrezeve lazer ka keto karakteristika:

- A) njëngjyrëshe, paralele, koherente
- B) njëngjyrëshe, paralele, jokoherente
- C) shumë ngjyrëshe paralele, koherente
- D) shumë ngjyrëshe paralele, jokoherente

30. Drita Lazer nuk perdoret në:

- A) kirurgji
- B) dermatologji
- C) fizioterapi
- D) gjinekologji

31. Aparatet e lazerterapise që përdoren në rehabilitim përdorin si mjet aktiv:

- A) argonin
- B) dioksid karbonin
- C) kriptonin
- D) rubinin

32. Ultratingujt janë vibrime akustike të pa perceptueshme nga veshi i njeriut me frekuence:

- A) nën 16.000 Hz
- B) mbi 16000 Hz
- C) nën 26000 Hz
- D) mbi 26000 Hz

33. Efektet e terapisë me ultratinguj në rehabilitim mund t'i përmbledhin në:

- A) mekanik, infiamator, termik, kavitar
- B) termik, kavitar, shkrirës, antiedematoz
- C) mekanik, termik, kimik, kavitar
- D) antiedematoz, kimik, termik, mekanik

34. Modaliteti më i përdorur dhe efikas i terapisë me ultratinguj është:



- A) me kontakt direkt
- B) me lëvizje rrotulluese të kokës
- C) me lëvizje perpendikulare
- D) me lëvizje gjatesore të kokës

35. Terapia me ultratinguj kunderindikohet në:

- A) çrregullime të sensibilitetit
- B) kalçifikime
- C) tendinite
- D) borsite

36. Sonoforesa është terapi përshpejtimi medikamentesh me anë të:

- A) rrymës elektrike
- B) mikrovaleve
- C) ultratingujve
- D) lazerit

37. Infiamacioni karakterizohet nga këto shenja:

- A) dolor, kalor, tumor, rubor, funksioneza
- B) dolor, rubor, kalor, tumor, nekroza
- C) kalor, tumor, dolor, hiperplazia, nekroza
- D) hiperplazia, nekroza, dolor, funksioneza

38. Terapia antalgjike me korente interferenciale gjen indikacion të gjerë:

- A) në dhimbjen sipërfaqësore
- B) në dhimbjen e fantazëm
- C) në dhimbjen e thellë
- D) në dhimbjen e mprehtë

39. Në dhimbjen e artikulationit tempo-mandibular modalitet terapeutike që përdoren janë:

- A) mikrovalët, lazeri, ultratingujt
- B) TENS, radarterapi, korente interferenciale
- C) presoterapi, radarterapi, korente interferenciale
- D) ultratingujt, TENS, lazer

40. Trigger point janë pika:

- A) të padhimbshme të trupit
- B) të agopunturës
- C) shumë të dhimbshme
- D) ku vendosen elektrodat e TENS

41. Rrymat diadinamike janë:

- A) rryma galvanike
- B) rryma alternative retangolare
- C) rryma sinusoidale me frekuence të ulët
- D) rryma të kombinuara

42. Efektet fiziologjike të rrymave diadinamike nuk lidhen me:
- A) shtimin e vazokonstriksionit
  - B) shtimin e vazodilatacionit
  - C) rritjen e permeabilitetit të membranës qelizore
  - D) rritjen e ngacmueshmerisë së fibrave nervore me kalibër të madh
43. Rrymat diadinamike nuk kunderindikohen:
- A) në hemoragji
  - B) frakturat e pakonsoliduara
  - C) shtatzani
  - D) gonartrozë
44. Reobaza është:
- A) zona e muskulit ku intensiteti është maksimal
  - B) intensiteti minimal i impulsit i aftë të shkaktoj kontraktim muskular.
  - C) intensiteti maksimal i impulsit i aftë të shkaktoj kontraktim muskular
  - D) pjesë e placës neuromotore
45. Elektrodat më komode në përdorim gjatë elektroterapisë janë:
- A) plastike
  - B) metalike
  - C) sfungjerore
  - D) autoaderente
46. Manjeto terapia indikohet:
- A) osteoporoze
  - B) hemiplegji
  - C) paraplegji
  - D) hypotoni
47. Llampat ultraviolet nuk japin:
- A) djersitje
  - B) vazodilatacion
  - C) vazokuksion
  - D) ulje të dhimbjes
48. Terapia fizike:
- A) ka vetëm efekt placebo
  - B) nuk perdoret vitet e fundit ne rehabilitim
  - C) perdoret gjerësisht në rehabilitim
  - D) perdoret gjithmone e kombinuar me terapinë medikamentoze
49. Krioterapia perdoret në:
- A) morth
  - B) në tendinit
  - C) anestezi e lëkurës

D) plagët e hapura

#### 4. Neurologji dhe Rehabilitim në Neurologji

1. Baza teorike e rehabilitimit fizik në sëmundjet neurologjike konsiston në:

- A) Neuroplasticitetin e qelizës nervore.
- B) Aftësinë kontraktuese të muskujve të gjymtyreve.
- C) Regjenerimin e qelizave nervore të dëmtuara.
- D) Të gjitha

2. Në personat që janë diagnostikuar me aksident cerebrovascular procedurat e rehabilitimit fizik duhet të fillojnë:

- A) Tre javë pas instalimit të deficitit neurologjik.
- B) Menjëherë pas diagnostikimit.
- C) Menjëherë pas instalimit të deficitit neurologjik.
- D) Asnjë.

3. Cili nga formacionet e mëposhtme merret me lëvizjet e vullnetshme?

- A) Cerebelliumi.
- B) Sistemi extrapyramidal.
- C) Trakti cortico-spinal.
- D) Trakti radiculo-spono-talamo-cortical.

4. Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme janë të kundërlindikuara procedurat e rehabilitimit fizik?

- A) Sëmundjen e Parkinsonit.
- B) Hemorragjinë cerebrale.
- C) Gjendjet pas interventeve për tumor cerebral.
- D) Myasthenia grave.

5. Cilën nga procedurat e mëposhtme do të zgjidhni si më efektive në personat që vuajnë nga Sëmundja e Parkinsonit dhe që janë në stadin II ose III të sëmundjes sipas Klasifikimit Hoehn dhe Yahr?

- A) "Pole Striding Exercises Program"
- B) "Range of Motion"
- C) "Neuro-development Training"
- D) Asnjë.

6. Sa % e pacientëve kanë përmirësim statistikisht të rëndësishëm nga procedurat e rehabilitimit fizik në sëmundjen cerebrovaskulare?

- A) 40%
- B) 8
- C) 100%
- D) asnjë

7. Rehabilitimi konjitiv është statistikisht më i efektshëm në:

- A) Polyradikuloneuritit inflamator akut të tipit Guillain-Barre.

- B) Sëmurdjen e Alzheimer.
- C) Sklerozën multiple.
- D) Demencën vaskulare.

8. Terapia okupacionale mund të përdoret si terapi initiale krahas trajtimit farmakologjik në personat që vuajnë nga:

- A) migrena
- B) hernia discale.
- C) ischemia cerebrale.
- D) sindromet demenciale.

9. Teknikat Bobath nuk përdoren në të sëmurët me:

- A) hernie diskale.
- B) hemorragji cerebrale.
- C) ishemi cerebrale.
- D) sëmundjen e parkinsonit.

10. Në të sëmurët që vuajnë nga skleroza multiple rehabilitimi fizik aplikohet:

- A) Vetëm në fazën fillestare të sëmundjes.
- B) Në momentin kur shfaqen deficitet motore.
- C) Gjatë gjithë evolucionit të sëmundjes.
- D) Asnjë.

11. Në të sëmurët që vuajnë me sëmundjen e parkinsonit procedurat e rehabilitimit fizik aplikohen:

- A) Para fillimit të farmakoterapisë.
- B) Pas ndërprerjes së farmakoterapisë.
- C) Njëkohësisht me farmakoterapinë.
- D) Asnjë

12. Në cilën nga patologjitë e mëposhtme janë të indikuara terapitë fizike në grup?

- A) Sindromet radikulare.
- B) Epilepsitë.
- C) Migrenat hemiplegjike.
- D) Sklerozën multiple.

13. Rehabilitimi i gëlltitjes aplikohet në:

- A) Sindromet bulbare.
- B) Sindromet e këndit ponto-cerebellar.
- C) Polyneuropathine diabetike.
- D) Të gjitha

14. Në të sëmurët që kanë pësuar traumë craniale dhe që paraqesin deficite motore dhe konjitive, rehabilitimi konjitiv duhet të fillohet:

- A) Pas rifitimit të aftësive fizike.
- B) Paralelisht me rehabilitimin fizik.

- C) Para rehabilitimit fizik.
- D) Nuk aplikohet fare.

15. Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme rehabilitimi fizik nuk paraqet sinjifikancë statistikore?

- A) Infarkt cerebrale.
- B) Hemorragjine cerebrale.
- C) Sëmundjen e Alzheimer.
- D) Sëmundjen e motoneuronit.

16. Cilën nga terapitë e mëposhtme do të preferonit për një të sëmurë që vuan prej shumë kohësh me epilepsi farmakorezistente?

- A) Kineziterapi.
- B) Psikoterapi.
- C) Hidroterapi.
- D) Terapi konjitive.

17. Në cilën nga patologjitë e mëposhtme ka vlerë trajnimi i familjareve mbi procedurat e rehabilitimit fizik?

- A) Hemiplegjite pas sëmundjes cerebrovaskulare.
- B) Herniet discale lumbare.
- C) Fibromyalgjinë.
- D) Të gjitha

18. Cila nga procedurat e mëposhtme nuk ka sinjifikance statistikore në të sëmurët me fibromyalgi?

- A) Kineziterapia.
- B) Masoterapia.
- C) Hydroterapia.
- D) Asnjë.

19. Hydroterapia është statistikisht sinjifikante në:

- A) Sklerozën amyotrofike laterale.
- B) Myasthenia grave.
- C) Sklerozën multiple.
- D) Sëmundjen e Alzheimer.

20. Masoterapia kundërrindikohet në:

- A) Fazën acute të sindromeve radikulare.
- B) Sëmundjen e parkinsonit.
- C) Polyneuropathitë.
- D) Te gjitha.

21. Në polyradikuloneuritit inflamator akut të tipit gullaun Barre Landry kineziterapia duhet të fillohet:

- A) 2-3 jave pas fillimit të sëmundjes.
- B) Menjëherë pas instalimit të deficitit motor.

- C) 2-3 dite pas fillimit të sëmundjes.
- D) Asnjë.

22. Kur nuk duhet aplikuar kineziterapia në polyneuropathinë diabetike:

- A) Kur dëmtimi aksonal është shumë i rëndë.
- B) Në fazën e dhimbshme.
- C) Pas trajtimit farmakologjik.
- D) Në fazën fillestare.

23. Në fazën terminale të sëmundjes së Duchenne do të sugjeronit:

- A) Kineziterapi.
- B) Masoterapi.
- C) Teknika të rehabilitimit pulmonar.
- D) Terapi okupacionale.

24. Metodat Alpini kanë sinjifikancë statistikore në:

- A) Hemorragjitë cerebrale.
- B) Sëmundjen e Parkinsonit.
- C) Chorea Huntington.
- D) Sindromet vertiginoze.

25. Cila nga procedurat e mëposhtme ka sinjifikancë statistikore të të semuret pas interventit për hernie discale lumbare?

- A) Ushtrimet në pishinë.
- B) Masoterapia.
- C) Ozonoterapia.
- D) Akupunktura.

26. Në cilin nga rastet e mëposhtme kundërintikohet kineziterapia?

- A) Në ishemi cerebellare.
- B) Në stadin akut të hernies discale.
- C) Në hemiparezat pas extirpimit të tumoreve cerebrale.
- D) Në fibromyalgi.

27. Në paralizen cerebrale spastike infantile nuk duhet të aplikohet:

- A) Kineziterapi.
- B) Hidroterapi.
- C) Masoterapia.
- D) Të gjitha.

28. Në Myotonine e tipit Steinert kineziterapia përdoret për:

- A) Të rivendosur motorikën e humbur.
- B) Për të plotësuar farmakoterapinë.
- C) Për të ruajtur funksionin motor të mbetur.
- D) Për të ngadalësuar progresionin e deficitit motor të kompromentuar.

29. Riedukimi i ecjes ka sinjifikance statistikore në:
- A) Hemiparezat post sëmundjes cerebrovasculare.
  - B) Polyneuropathitë axonale motore.
  - C) Myopathitë.
  - D) Distrofite mskulare.
30. Në sklerozën multiple procedura e rehabilitimit fizik ndikojnë në:
- A) Zhdukjen e deficiteve motore.
  - B) Pjesëmarrje më aktive në aktivitetet e jetës së përditshme.
  - C) Uljen e mundësisë së shfaqjes së pllakave demielinizante.
  - D) Asnjë.
31. Elementët e ekzaminimit logopedik:
- A) Marrja e të dhënave të anamnezës.
  - B) Ekzaminimi i të folurit oral.
  - C) Ekzaminimi i strukturës së fjalisë.
  - D) Të gjitha alternativat.
  - E) Asnjëra nga alterntivat.
32. Seanca e rehabilitimit tek i sëmuri me Parkinson duhet të fillojë:
- A) Gjysëm ore pas terapisë medikamentose
  - B) Një orë pas terapisë medikanentose
  - C) Dy orë pas terapisë medikamentose
  - D) Tre orë pas terapisë medikamentose
33. Sipas Meckenzie pacientit me hernie diskale posteriore L5-S1 i duhet përdorur:
- A) parimi i ektensionit të shtyllës kurrizore
  - B) parimi i fleksionit të shtyllës kurrizore
  - C) parimi i inklinimit lateral të shtyllës kurrizore
  - D) parimi i rrotullimit të shtyllës kurrizore
34. Në hemiplejinë e djathtë tek i rrituri është e rëndesishme:
- A) forcimi i muskujve të gjymtyrëve të poshtme
  - B) korrigjimi i skemës patologjike
  - C) linfodrenazhi i gjymtyrës së sipërme
  - D) ecja drejt e pacientit
35. Për përmiresimin e levizshmërisë tek i sëmuri me Parkinson duhen perdorur:
- A) ushtrime me rezistencë
  - B) ushtrime te lira pa rezistencë po me ritëm
  - C) skema ushtimesh mbyllëse pa ritem
  - D) stimuj propioceptiv
36. Në fazën e avancuar të miastenesë grave ka shumë rëndesi:
- A) gjimnastika respiratore
  - B) ruajtja e performances su muskujve skeletikë

- C) bashkëpunimi me psikologun
- D) vlerësimi postural i pacientit

37. Levizja si rrotë e dhëmbëzuar e parakrahut është pasojë:

- A) e hipertonisë piramidale
- B) e hipertonisë ekstrapiramidale
- C) e çrregullimeve të ekujlibrit
- D) e pozicionimit të keq

38. Tek pacienti paraplegjik ka rëndësi të madhe për të dhënë automi:

- A) ushtrimet e ekujlibrit
- B) forcimi i gjymtyrëve të sipërme
- C) forcimi i gjymtyrëve të poshtëme
- D) ushtrimet e kombinuara

39. Në fazën akute të paralizës periferike të nervit facial nuk duhet përdorur:

- A) termoterapia nga faqja e paralizuar
- B) termoterapia nga faqja e shëndoshë
- C) lëndodrenazhi sipas Leduk
- D) trajtimi i përditshëm

40. Parimi kryesor në rehabilitimin e neuropatite periferike është:

- A) rifitimi i forcës muskulare
- B) ulja e tonusit muskular
- C) parandalimi i iperrefleksisë
- D) modifikimi i ROM-it artikular

41. Fizioterapia në distrofinë muskulare Duchenne ka si qëllim:

- A) të sforcoj pacientin për të ruajtur masën muskulare
- B) të shtoj performancën e pacientit
- C) të ruaj sa më gjatë autonominë e pacienti
- D) të përmirësojmë lëvizshmërinë artikulare

42. Hipertonusi i tipit piramidale ulet me:

- A) termoterapi direkte dhe indirekte
- B) krioterapi
- C) rinforsim muskular të gjymtyrëve
- D) terapi posturale

43. Ndrëhyrja kirurgjikale për lirimin e nervit median në sindromin e tunelit karpal indikohet vetëm kur:

- A) pacienti ka alergji nga medikamentet
- B) pacienti refuzon terapitë e tjera
- C) kur trajtimi konservativ ka falimentuar
- D) kur pacienti vazhdon të ketë temperature të dorës



44. Tek pacientët me paraliza të nervave periferikë kemi:

- A) hiperefleksi
- B) hipertonus
- C) hypotonus
- D) hypotension

45. Tek pacientët me patologji cerebelare kanë rëndësi të veçantë:

- A) ushtrimet e ekujlibrit
- B) ushtrimet e forcës
- C) ushtrimet e rezistencës
- D) ushtrimet e zgjatjes

46. Në sëmundjen e Parkinsonit kemi:

- A) ulje të serotoninës
- B) rritje të serotoninës
- C) rritje të dopaminës
- D) ulje të dopaminës

47. Distonia është çrregullim:

- A) piramidal
- B) extrapiramidal
- C) cerebelar
- D) midolar

48. Diplegjia intereson:

- A) gjymtyrët e sipërme
- B) gjymtyrët e poshtëme
- C) të katër gjymtyrët po në mënyrë asimetrike
- D) të katër gjymtyrët në mënyrë simetrike

49. Në ditët e para pas insultit cerebral fizioterapist duhet:

- A) të ruaj forcën e anës plegjike
- B) të pozicionaj mirë anën plegjike që të parandaloj ekuinizmin e
- C) të stimuloj refleksët e anës plegjike
- D) të stimuloj ritjen e tonusit muskular

50. Ndërhyrja kirurgjikale për lirimin e nervit median në sindromin e tunelit karpal indikohet vetëm kur:

- A) pacienti ka alergji nga medikamentet
- B) pacienti refuzon terapitë e tjera
- C) kur trajtimi konservativ ka falimentuar
- D) kur pacienti vazhdon të ketë temperaturë të dorës

51. Pacienti me hipertonus piramidal quhet ndryshe:

- A) tonik
- B) spastik

- C) hemiplegjik
- D) paraplegjik

52. Pacientët që kanë rigiditet:

- A) kanë dhe hypotoni
- B) kanë reaksione ekuilibri shumë skadente
- C) nuk kanë problem me ekuilibrin por janë pak të ngurtesuar
- D) kanë gjithmonë një tendencë për të korigjuar pozicionin e trupit

53. Plani jostabël përdoret tek pacientët me:

- A) spina bifida
- B) tetraplegji
- C) distoni
- D) çrregullime ekuilibri

54. Fizioterapia tek pacienti neurologjik ka si qëllim:

- A) ngritjen në këmbë të pacientit
- B) përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientit
- C) rritjen e motivimit të pacientit
- D) mos keqësimin e gjendjes së pacientit

55. Triada që karakterizon sëmundjen e parkinsonit është:

- A) hiperkinezi, parestezi, tremor
- B) hiperkinezi, asteni, tremor
- C) hypokinezi, rigiditet, tremor
- D) hypokinezi, asteni, tremor

56. Shkalla e Glasgow përdoret:

- A) për të vlerësuar gjendjen e neonatit pas lindjes
- B) gjendjen e ndërgjegjes
- C) për të vlerësuar risqet e hipertensionit
- D) për të vlerësuar refleksat e thella

57. Pacienti me afazi të tipit Wernicke:

- A) është në gjendje të dëgjojë të kuptojë por nuk flet dot
- B) nuk është në gjendje as të dëgjojë as të kuptojë
- C) flet rrjedhshëm por biseda e tij është pa sens llogjik
- D) flet rrjedhshëm por nuk dëgjon

58. Në faktorët e riskut për insult cerebral futen

- A) hipertensioni, duhani, alkooli
- B) alkooli duhani, avitaminozat
- C) duhani, aspirina, hipertensioni
- D) alkooli, heparina, duhani

59. Neuropatia periferike nuk mund të shkaktohet nga:

- A) diabeti
- B) avitaminozat
- C) alkooli
- D) hypotensioni

60. C'rregullimet e ekuilibrit nuk varen nga:

- A) patologji te veshit te brendshëm
- B) artroza cervikale
- C) patologjitë e cerebelumit
- D) distrofia muskulare

61. Nistagmushi është një shenjë klinike që i referohet aparatit:

- A) lokomotor
- B) digeent
- C) viziv
- D) ekskretor

62. Paraplegjia intereson:

- A) gjysmën e majtë të trupi
- B) gjysmën e djathtë të trupit
- C) një nga gjymtyrët e poshtëme
- D) gjysmën inferiore të trupit

63. Ataksia është:

- A) çrregullim ekuilibri
- B) sinonim i afazise
- C) çrregullim i të folurit
- D) çrregullim i tonusit muskular

64. Skemat diagonale Kabat nuk përdoren:

- A) në tortikolin spastik
- B) në hemiplegjinë e majtë
- C) në hemiplegjinë e djathtë
- D) komën cerebrale

65. Në patologjitë e sistemit nervor qëndror nuk bën pjesë:

- A) skleroza me plaka
- B) aksidenti vaskulo cerebral
- C) tumori I crebelumit
- D) nevralgjia e nervit trigeminal

66. Përmirësimi i R.O.M-it artikular tek pacienti hemiplegjik duhet të filloj nga pjesa:

- A) proksimale e gjymtyrës
- B) distale e gjymtyrës
- C) mediale e gjymtyrës
- D) laterale e gjymtyrës

67. Distonia është çrregullim i sistemit:

- A) piramidal
- B) ekstrapiramidal
- C) cerebellar
- D) bulbar

68. Atetoza karakterizohet nga lëvizje:

- A) të ngadalta dhe jo ritmike të pjesëve proksimale të gjymtyrëve
- B) të ngadalta dhe jo ritmike të pjesëve distal të gjymtyrëve
- C) të shpejta dhe jo ritmike të pjesëve proksimale të gjymtyrëve
- D) të shpejta dhe jo ritmike të pjesëve distal të gjymtyrëve

69. Nuk bën pjesë në shkaqet e sindromit cerebellar:

- A) neoplazitë
- B) traumat kranio-encefalike
- C) alkoolizmi kronik
- D) hiperkolesterolemia

70. Objektivat rehabilituese në javët e parë pas një traume midolare janë:

- A) parandalimi i dukubituseve, kontrakturave, pneumonisë
- B) rikuperimi funksional i palcës së kurrizit
- C) rritimi i ndërgjegjes së pacientit
- D) riedukimi i ecjes së pacientit

71. Pacienti me hernie diskale duhet të nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale vetëm kur:

- A) hernia është L5-S1
- B) hernia është në më shumë se një disk intervertebral
- C) klinika e pacientit vazhdon të rëndohet dhe pas 4 javësh trajtim konservativ
- D) klinika e pacientit vazhdon të rëndohet dhe pas 8 javësh trajtim konservativ

72. Afazia është:

- A) çrregullim i të folurit me origjinë periferike
- B) çrregullim i të folurit me origjinë qendrore
- C) dëmtim i muskujve fonatore
- D) i kordave të zërit

73. Rikuperimi funksional maksimal i pacientëve me iskemi cerebrale ndodh brenda:

- A) 2 muajve të parë
- B) 4 muajve të parë
- C) 6 muajve të parë
- D) 8 muajve të parë

74. Encefaliti është patologji:

- A) degjenerative e SNQ
- B) inflamtoe e SNQ

- C) traumatike e SNQ
- D) hereditare e SNQ

75. Atrofia muskulare spinale është patologji:

- A) degjenerative e SNQ me bazë karencen e vitamins B1
- B) degjenerative e SNQ me bazë gjenetike
- C) inflamatore e muskujve
- D) degjenerative e muskujve

76. Nuk është teknike e rehabilitimit neuromuskular teknika:

- A) Bobath
- B) Vojta
- C) Kabat
- D) Mezieres

77. Delirium tremens është patologji:

- A) pasoje e alkolizmit kronik së bashku polineuropatine alkolike
- B) pasoje e alkolizmit kronik së bashku me hipertone muskulare
- C) çrregullim humori bipolar
- D) çrregullim i ideve tek pacienti skizofrenik

78. Fizioterapisti përpara fillimit të një seance rehabilitimi tek pacienti komatoz duhet:

- A) t'i bëjë terapinë medikamentoze pacientit
- B) të ketë bërë kateterizimin e pacientit
- C) të informohet mbi gjendjen e pacientit
- D) ta ftojë pacientin për bashkëpunim

## **5. Psikiatri dhe Rehabilitim Psikiatrik**

1. Halucinacionet janë çrregullime të:

- A) mendimit
- B) perceptimeve
- C) humorit
- D) Sjelljes

2. Halucinacioni auditiv është perceptimi i rremë i:

- A) lëvizjeve
- B) sjelljeve
- C) tingujve, zërave, zhurmave
- D) objekteve

3. Halucinacioni viziv është perceptimi i rremë i:

- A) zhurmave
- B) goditjeve
- C) i figurave, sendeve, objekteve
- D) sjelljeve bizare

4. Halucinacioni olfaktiv është perceptimi i remë i:

- A) xhurmave
- B) mendimit
- C) sjelljeve
- D) nuhatjes

5. Iluzionet janë:

- A) perceptime të reme
- B) fantazi
- C) perceptime të gabuara
- D) paradoksalitet

6. Psikoza është:

- A) azhitim psikomotor
- B) paaftësia për të dalluar realitetin nga fantazia
- C) gjendje me humor të lartë
- D) cregullim gjumi

7. Logore është:

- A) inkoherenca e të folurit
- B) shtimi i sasise se te folurit shpejtësisë të të folurit
- C) paradoksalitet
- D) mungesë të foluri

8. Mutizmi është:

- A) ngadalësim i të folurit
- B) i folur me shenja
- C) frenim i të folurit
- D) i folur paradoksal

9. Solilokia është:

- A) cregullim mendimi
- B) i folur me vete
- C) crregullim sjelleje
- D) neologjizëm

10. Tangencialiteti është:

- A) sallata e fjalëve
- B) inkoherencë
- C) përgjigje anash
- D) viskozitet në mendim

11. Të menduarit paradoksal është:

- A) shpeshtësi e të menduarit
- B) të menduar bizar, pa kuptim
- C) tangensialitet

D) Viskozitet mendimi

12. A zbuten deluzionet me anën e:

- A) bindjes dhe argumentit
- B) forcës fizike
- C) halucinacionit
- D) forcës psiqike

13. Deluzionet janë cregullime të:

- A) percpsioneve
- B) mendimit
- C) humorit
- D) Sjelljes

14. Deluzioni është:

- A) të menduar bosh, pa kuptim
- B) besim i gabuar, konkluzion i pasaktë
- C) bindje që bazohet mbi fakte reale
- D) argument shkencor

15. Deluzioni bizar është:

- A) dëmtimi i skemës së trupit
- B) fakt real
- C) argument shkencor
- D) bindje absurde, e paarsyeshme

16. Deluzioni i persekutimit është bindja e gabuar se:

- A) po e tradhëtojnë
- B) se është i sëmure me SIDA
- C) po e ndjekin, mashtrojnë, sulmojnë
- D) ka prejardhje fisnikësh

17. Deluzionet e referencës lidhen me bindjen se:

- A) vjen nga prejardheje e lartë
- B) ka ndjesinë e përndjekjes
- C) është infektuar nga viruse të ralla
- D) TV i dërgon mesazhe dhe ngado i vijnë sinjale

18. Deluzionet e veteakuzimit është bindja e gabuar se:

- A) është mashtruar dhe tradhëtuar
- B) se ka bërë faje të rënda dhe duhet ndëshkuar
- C) organet e trupit janë të deformuar
- D) fytyra është shtrembëruar

19. Obsesionet janë:

- A) persistomi patologjik i një mendimi, impulsi, përfytyrimi

- B) bindje të gabuar
- C) perceptimi remë i tingujve, zhurmave
- D) vështirësi në përqëndrim

20. Fobia është:

- A) mendim bizare
- B) frikë patologjike e ekzagjeruar me objekt real
- C) mendim i imponuar nga jashtë
- D) përfytyrim

21. Paramimia është:

- A) bizaritet
- B) dëshpërim
- C) nivel i lartë humori
- D) mospërputhja e emocionit me reagimin

22. Amnezitë janë cregullime të:

- A) motorikës
- B) kujtesës
- C) folurit
- D) lëvizjeve të vullnetëshme

23. Katatonia është crregullim i:

- A) mendimit
- B) humorit
- C) sjelljes
- D) pamjes

24. Koeficienti i inteligjences (IQ) 40 pikë është prapambetje mendore:

- A) e rëndë
- B) e moderuar
- C) e lehtë
- D) shumë e thellë

25. Disforia është humor:

- A) i lartë
- B) irrituar
- C) Depresiv
- D) i shqetësuar

26. Euforia është gjendje humori:

- A) e lartë
- B) shumë e lartë
- C) e irritushme
- D) Ekspansiv



27. Humori depresiv është:

- A) humor disforik
- B) humor i paqëndrushëm
- C) mërzi dhe dëshpërim
- D) humor i irritushëm

28. Negativizmi është crregullim i:

- A) mendimit
- B) sjelljes
- C) humorit
- D) i perceptioneve

29. Agresiviteti është:

- A) humor i irrituar
- B) shtim i veprimtarisë psikomotore
- C) refuzim mjekimi
- D) psikoze

30. Komunikimi verbal është:

- A) të thuash çfarë ke ndërmend
- B) të jesh i tërthortë
- C) të thuash vetëm të vërtetën
- D) të shkruash mendimin

31. Komunikimi jo verbal është:

- A) të thuash atë që ke ndërmend
- B) shfaqja e jashtme e asaj që ke ndërmend
- C) është komunikim terapeutik
- D) Të thuash të kundërtën e asaj që mendon

32. Komunikimi terapeutik është:

- A) komunikimi mes fizioterapisteve
- B) mjek-mjek
- C) infermier-mjek
- D) infermier -pacient

33. Komunikimi terapeutik është më i rehatshëm kur infermieri dhe pacienti janë larg njeri tjetrit:

- A) 1.5 m
- B) 45 cm
- C) 2.5 m
- D) 50 cm

34. A është komunikim jo terapeutikë:

- A) pranimi
- B) kundërshtimi
- C) miratimi

D) rënia dakord

35. Rehabilitimi psikiatrik përfshin:

- A) institucionalizimin
- B) trajtim me preparate
- C) psikoterapi
- D) trajtimin biologjik

36. Psikoterapitë përdorin teknikat:

- A) biologjike
- B) psikologjike
- C) sociale
- D) kirurgjikale

37. Psikoterapitë trajtojnë:

- A) probleme të rënda shëndetësore
- B) probleme të sjelljes dhe emocioneve
- C) parandalim dhe profilaksi
- D) probleme kozmetike

38. Psikoterapia ndihmon për:

- A) reduktimin e varfërisë
- B) të mëson të flasësh
- C) të mëson të punosh me profesionalizëm
- D) të mësuar mënyra të reja sjelljeje

39. Cfarë nuk është qëllim i rehabilitimit psikiatrik?

- A) përmirësimi i sëmundjes mendore
- B) punësimi
- C) riintegrimi në komunitet
- D) rritja e pavarësisë

## **6. Neurolinguistikë dhe Rehabilitim i të Folurit**

1. Të komunikosh do të thotë:

- A) të përdorësh gjuhën e nënës
- B) të japësh një informacion për të tjerët
- C) të pyesim dikë për dicka
- D) të dish të flasësh

2. Në cilën moshë fëmija e bën të tijën gjuhën?

- A) 12 muajsh
- B) 3 vjec
- C) 6 vjec
- D) 8 vjec

3. Etapa paragjuhësore mbulon moshën:

- A) 0-5 muaj
- B) 0-18 muaj
- C) 2-3 vjec
- D) mbi 6 vjec

4. Logopedistët janë specialistë:

- A) klinik
- B) Biologjik
- C) social
- D) para-klinik

5. Disfazia motore është:

- A) vështirësi në të kuptuar
- B) crregullim i shprehjes verbale
- C) belbëzim
- D) mutizëm

6. Vonesa e lehtë e gjuhës është:

- A) gërmëzimi
- B) surdomutizëm
- C) mutizëm selektiv
- D) vonesa e fjalës së parë

7. Vonesa e gjuhës është:

- A) belbëzim
- B) paaftësia për të vargëzuar tingujt në fjalë
- C) mutizëm selektiv
- D) defekt i dëgjimit

8. Dislalia është:

- A) vonesë në fjalën e parë
- B) defekt në shqiptimin e tingullit
- C) surdomutizëm
- D) paaftësia për të vargëzuar tingujt në fjalë

9. Cilat nga crregullimet gjuhësore është prezent në prapambetjen mendore të moderuar?

- A) vonesa e fjalës së parë
- B) logorea
- C) disfazia
- D) belbëzimi

10. Cili organ është quajtur 'gjenerator i zërit'?

- A) truri
- B) laringu
- C) mushkëritë

D) diafragma

## 7. Neuropsikiatri Infantile dhe Rehabilitim i Saj

1. Fëmija ka kontroll të posturës në:

- A) 3 vjeç
- B) 4 vjeç
- C) 5 vjeç
- D) 6 vjeç

2. Frika dhe tmerret e nates hasen kryesisht tek femijet:

- A) 0-12 muajsh.
- B) 2-3 vjec.
- C) Parashkolloret.
- D) Adoleshence.

3. Fëmija di emrin dhe moshën deri në:

- A) 2 vjeç
- B) 3 vjeç
- C) 4 vjeç
- D) 5 vjeç

4. Refleksi Moro zhvillohet në

- A) 1 muajsh
- B) 4 muajsh
- C) 8 muajsh
- D) 10 muajsh

5. Belbezimi është çrregullim:

- A) I perceptimit.
- B) I rrjedhshmerise ne te folur.
- C) I konjcionit.
- D) afektiv.

6. Gjени pergjigjen e pasakte per autizmin:

- A) Eshte semundje e moshes feminore.
- B) Eshte crregullim pervaziv i zhvillimit
- C) Diagnostikohet per here te pare para moshes 3 vjec.
- D) Mjekim i zgjedhur eshte ai medikamentoz.

7. Gjени pergjigjen e pasakte: Pavemendja e nje femije me crregullim te vemendjes se pamjaftuar konsiston kur shpesh:

- A) nuk u kushton vemendje detajeve ose ben gabime nga pakujdesia.
- B) ka veshtiresi per tu perqendruar tek detyrat apo tek loja.
- C) pret me durim rradhen e tij per te vepruar.
- D) nuk degjon kur i flitet direct.

8. Cila nga patologjite e meposhtme mund te jete e shoqeruar edhe me epilepsi?

- A) Autizmi.
- B) Crregullimi i vemendjes se pamjaftuar me hiperaktivitet.
- C) Depresioni feminor.
- D) Psikozat infantile.

9. Crregullimet e te nxenit karakterizohen nga:

- A) funksionim akademik i ulur ne krahasim me moshen kronologjike te femijes
- B) disfunksion semantico- pragmatic
- C) disfunksion fonologjik
- D) koordinim motor qe eshte shume poshte asaj te llogaritur per moshen kronologjike dhe inteligjences se matur te personit

10. Terapite me te perdorshme ne autizem jane te gjitha pervec njeres:

- A) ABA (Applied Behavioural Analysis)
- B) Terapia e muzikes
- C) Floor-Time
- D) Akupunktura

11. Autizmi infantil është një crregullim pervaziv i zhvillimit i percaktuar nga deficite ne tre fusha kryesore te poshteshenuara pervec njeres:

- A) Aftesite sociale, empatia dhe te kuptuarit e tjetrit
- B) Aspekte karakteristike fizike
- C) Komunikimi verbal dhe joverbal si dhe imagjinata
- D) Fleksibiliteti konjitiv dhe ne sjellje

12. Cila nga shifrat e meposhtme tregon frekuencen e prapambetjes mendore te rende te personat e diagnostikuar me prapambetje mendore?

- A) 1%
- B) 7%
- C) 12%
- D) 80%

13. Cili nga raportimet e meposhtme ne lidhje me hasjen e eneurezes nocturnae sipas grupmoshes është i gabuar?

- A) 1% e femijeve te moshes 5 vjec
- B) 3% e femijeve deri 8 vjec
- C) 4% e femijeve deri 14 vjec
- D) 10% e femijeve deri 18 vjec

14. Fëmijët vërejnë diferencën gjinore rreth moshës deri:

- A) 1 vjeç
- B) 2 vjeç
- C) 3 vjeç
- D) 4 vjeç

15. Pergjigje statistikisht sinjifikante ne depresionin te adoleshentet marrim gjate:
- A) Farmakoterapise
  - B) Psikoterapise
  - C) Kombinimi i te dyja me siper
  - D) Terapia elektrokonvulsive
16. Gjate femijerise simptomat obsessive e compulsive nuk hasen ne:
- A) çrregullimet e ankthit
  - B) çrregullimin depresiv
  - C) sindromin Gilles de la Tourette
  - D) çrregullimet e te nxenit
17. Nje prej simptomave te meposhtme te shfaqura para moshes 15 vjec nuk është pararendese e çrregullimeve te personalitetit:
- A) Ankthi nocturnae
  - B) Abuzimi me substance
  - C) Delikvence juvenile.
  - D) Genjeshtra te shpeshta
18. Sindromi Gilles de la Tourette ndodh per shkak te:
- A) demtimit te traktit kortiko-spinal
  - B) hipersensitivitetit dopaminergjik
  - C) traumes craniale
  - D) tumoreve te lobit frontal
19. Cili nga faktoret e meposhtem nuk ndikon ne shfaqjen e crregullimit te vemendjes se pamjaftueshme me hiperaktivitet?
- A) Faktoret gjenetike
  - B) Intoksikacioni me plumb
  - C) Hiperproteksioni prinderor
  - D) Faktoret social
20. Fëmija shfaq frikë ndaj të huajve:
- A) 0 - 1 muajshe
  - B) 1 - 3 muajshe
  - C) 4 - 8 muajshe
  - D) 9 - 12 muajsh
21. Trajtimi i crregullimeve te sjelljes perfshin te gjitha pervec njeres:
- A) Keshillim per prinderit
  - B) Terapi behavioriste
  - C) Terapi elektrokonvulsive
  - D) Farmakoterapi
22. Ne cilen nga patologjite e meposhtme nuk jane prezente halucinacionet?

- A) Çrregullimet e humorit
- B) Çrregullimet psikotike
- C) Çrregullimi disociativ
- D) Çrregullimi i stresit post- trauma

23. Cila nga çrregullimet e meposhtme nuk ben pjese ne çrregullimet e femijeve parashkollore?

- A) Mekja
- B) Çrregullimet e personalitetit
- C) Çrregullimet e gjumit
- D) Shperthimet e inatit.

24. Cila nga shenjat e meposhtme nuk ben pjese ne çrregullimet gjuhesore?

- A) Paaftesi per te ndjekur udhezimet
- B) Veshitresi ne ritmin, volumin ose cilesine e zerit
- C) Reduktimi i fjalorit
- D) Modele gramatikore te papershtatshme

25. Regresi gjuhesor mund te ndodhe ne:

- A) çrregullimin disintegrative te femijerise
- B) Epilepsi farmakorezistente
- C) çrregullimin obsesiv- kompulsiv
- D) çrregullimet fonologjike

26. Sindromi i ADHD është sëmundje:

- A) Genetike.
- B) Çrregullim metabolik.
- C) Çrregullim biokimik.
- D) hormonal.

27. IQ tek fëmijët me vështirësi në të nxënë është:

- A) Poshtë 59.
- B) 60-80.
- C) Mbi 80.
- D) nuk ka njesi matje.

28. Vështirësia në të nxënë kërkon:

- A) Edukim në qendra rezidenciale.
- B) Integrim në shkollë normale.
- C) Strategji bypass.
- D) Edukim ne izolim.

29. Testi i Denver është:

- A) Depistues.
- B) Vlerësues.
- C) Përcaktues i IQ.
- D) Mjekues.

30. Sindromi Down është çrregullim:  
A) Kromozomik  
B) I trashëguar  
C) I fituar  
D) Sëmundje infektive
31. Fëmija kap objekte në formë pincete në moshën:  
A) 0 - 4 muajshe  
B) 4 - 7 muajshe  
C) 8 - 9 muajshe  
D) 10 - 12 muajsh
32. Ekipi multidisiplinar gjeneron:  
A) Konflikt  
B) Konkurencë  
C) Bashkëpunim  
D) Pavarësi në punë
33. Paraliza cerebrale e tipit atetoze karakterizohet nga:  
A) lëvizje të pavullnetshme  
B) lëvizje normale  
C) lëvizje të vullnetëshme  
D) mungesë e lëvizje.
34. Zhvillimi është proces vetëm:  
A) Biologjik+ Kognitiv  
B) Kognitiv+ Socio-emocional  
C) Socio-emocional+ kognitiv  
D) Biologjik+ Kognitiv+ Socio-emocional
35. Proceset biologjike përfshijnë vetëm:  
A) Bilancin antropometerik +Aftësitë genetike  
B) Bilancin hormonal+ Aftësitë motorike  
C) Aftësitë motorike +Aftësitë genetike  
D) Aftësitë genetike+ motorike+ Bilancin hormonal+ antropometerik
36. Qeshja sociale ndodh në moshën:  
A) 0 - 1 muaj  
B) 1 - 4 muaj  
C) 5 - 6 muaj  
D) 7-12 muaj
37. Fëmija sjell duart në vijën e mesit në moshën:  
A) 0 - 1 muajshe  
B) 1 - 4 muajshe  
C) 5 - 8 muajshe



D) 9-12 muajshe

38. Fëmija kërkon objektin e fshehur në moshën:

A) 0 - 1 muajshe

B) 2 - 3 muajshe

C) 4 - 8 muajshe

D) 9 - 12 muajsh

## 8. Patologjitë e Aparatit Lokomotor dhe Rehabilitimi i Tyre

1. Trajtimi konservativ në coxa valga konsiston në:

A) Përforcimin muskular të muskujve të legenit dhe korigjimin e posturës,

B) Përmirësimin e sensibilitetit;

C) Zvogëlimin e tonusit muskular;

D) Zvogëlimin e këndit cerviko- diafizar të femorit.

2. Objektivi kryesor i trajtimit fizioterapeutik të një skolioze torakale në formë C është:

A) Përmirësimi i koordinimit sy -dorë;

B) Përforcimi i muskujve të gjymtyrëve të sipërme;

C) Zgjatja e muskujve të trungut të anës konkave;

D) Parandalimi i sindromit të piriformit.

3. Në një skoliozë në formë S, kur këndi i "Kobit" është më i vogël se 20 C; trajtimi konsiston në:

A) Gjimnastik

B) Vendosja e një allcie

C) Mbajtja e një orteze "Milwakee"

D) Trajtim kirurgjikal

4. Në rastin e frakturës Pouto-Colle komplikacioni më i shpeshtë është:

A) Periartriti skapularë;

B) Artriti Reumatoid;

C) Algoneurodistrofi e tipit 1 (CRPS 1) në gjymtyrën e sipërme;

D) Algoneurodistrofi e tipit 1 (CRPS 1) në gjymtyrën e poshtme.

5. Trajtimi afat shkurter (në fazën e allcisë) në frakturën Pouto-Colle konsiston:

A) Masazh dhe mobilizim pasiv në distancë, të gishtave dhe skapulës;

B) Masazh dhe mobilizim pasiv i brrylit dhe kyçit të dorës;

C) Përforcim i muskujve të parakrahut;

D) Mobilizim aktiv i kyçit të dorës;

6. Në një distorcion të kaviļjes, në fazën e parë të rehabilitimit janë të lejueshme lëvizjet e:

A) flexionit plantar dhe fleksionit dorsal;

B) Eversionit;

C) Inversionit;

D) Cirkonduksionit

7. Në një endoprotezë kokso-femorale, strukturat që mungojnë janë:

- A) Capsula artikulare;
- B) Ligamenti Capitis femori;
- C) Ligamenti pubo-femoral
- D) Muskuli ilio-ptoas

8. Në një luksacion anterior të supit, gjatë ekzaminimit pacienti ka dhimbje gjatë lëvizjes së:

- A) Fleksionit anterior të krahut deri në 90
- B) Inklinimit të qafes
- C) Fleksionit anterior të qafes
- D) Aduksionit dhe rrotacionit ekstern të krahut

9. Në një endoprotezë kokso-femorale nuk duhet të realizohen lëvizjet e:

- A) fleksion >90; rrotacion intern; adduksion në kokso femoral
- B) fleksion i plotë i gjurit
- C) fleksion dorsal; fleksion plantar i kaviljes
- D) Ekstension; rrotacion ekstern; abduksion në koksofemoral

10. Në një tendinit kemi:

- A) Inflamacion intraartikular
- B) Inflamacion të tendinit
- C) Këputje të tendinit
- D) Hemoragji intraartikulare

11. Fraktura e stresit shkaktohet nga:

- A) Mikrotrauma të përsëritura
- B) Një lëvizje violente
- C) Një aksident rrugor
- D) Një këputje e ligamenteve

12. Në borsitin subakromial:

- A) Koka humerale ka dalë nga fosa glenoidale
- B) Kemi rupturë totale të tendinit të kokës së gjatë të bicepsit
- C) Artrodezë të artikulacionit glenohumeral
- D) Depozitim dhe grumbullim të joneve të kalciumit në nivel të bursës

13. Në frakturat e pakonsoliduara kundërrindikohet absolutisht:

- A) ortezat fiksuese
- B) imobilizimi me allçi
- C) imobilizimi i segmentit të frakturuar
- D) imobilizimi i segmentit në distance

14. Periatriti scapula-homeral nuk shkaktohet nga:

- A) ngushtimi i lindur i hapsirës sub-akromiale
- B) osteoporoza
- C) mbingarkesa funksionale

D) prishja e raporteve artikulare

15. Dy ditet e para pas një distorcioni të kavilies duhet përdorur:

- A) termoterapi, ngritje e këmbës, pushim, funksional
- B) krioterapi, fashim, ngritje e këmbës, pushim funksional
- C) krioterapi, termoterapi, fashim
- D) fashim, ushtrime, akull, biciklete.

16. Distorcioni i gjurit çon në dëmtim të:

- A) palcës së kockës
- B) ligamenteve dhe menisqeve
- C) osteoblasteve
- D) gjurit tjetër

17. Frakturat në moshat pediatrike:

- A) janë gjithnje të komplikuar
- B) janë shumë të shpeshta
- C) janë si dru i njome
- D) konsolidohen brenda javës

18. Një ndër shkaqet e algoneurodistrofi është:

- A) terapia medikamentoze jo e saktë
- B) traumat kockore
- C) ushtrimet me ngarkesë të madhe
- D) masoterapia

19. Protezat janë:

- A) zëvendësues të artikulacioneve të gjurit
- B) ndihmues të jashtëm që përmirësojnë funksionin e një pjese të trupit
- C) korrigjues të amputimeve të gjymtyrëve
- D) aparate për stimulimin e muskujve

20. Protezat janë:

- A) pjesë e një artikulacioni
- B) ndihmues të një artikulacioni
- C) zëvendësues të një strukture anatomike
- D) korrigjues të një strukture anatomike

## **9. Teknika të Rehabilitimit Special**

1. Rehabilitimi kardiak është nje proçes që realizohet nga:

- A) Kardiologu
- B) Fizioterapisti
- C) Psikologu
- D) Staf multidisiplinar

2. Programi i rehabilitimit kardiak ndahet në:

- A) 4 faza
- B) 5 faza
- C) 6 faza
- D) 2 faza

3. Kundërrindikimet për lënien e fizioterapisë gjatë rehabilitimit kardiak është:

- A) Stenoze e aortës
- B) Gastrit
- C) Migrenë
- D) Depresion

4. Angina Pectoris është:

- A) Nekrozë e miokardit
- B) Ishemi e miokardit
- C) Nekrozë endokardit
- D) Ishemi e endokardit

5. Hipertensioni arterial përkufizohet si rritje e presionit të gjakut në shifrat mbi:

- A) 120
- B) 110
- C) 100
- D) 140

6. Ushtrimet që rekomandohen në hipertensionin arterial janë:

- A) Ushtrime relaksuese të muskulaturës së përgjithshme
- B) Ushtrime për rforcim muskular
- C) Ushtrime për ekuilibrin
- D) Streçing

7. Shkaqet me origjinë jo kardiake të hipotensionit janë:

- A) Qëndrimi i zgjatur në regjim shtrati
- B) Duhani
- C) Hiperaktiviteti fizik
- D) Përdorimi i tepruar i kripës

8. Ena më e madhe e sistemit limfatik është:

- A) Vena femorale
- B) Vena lienale
- C) Ductus toracik
- D) Aorta torakale

9. Limfonodulat e sistemit limfatik gjenden në:

- A) Fossa poplitea
- B) Artikulacionin coxo-femoral
- C) Hapsirat intercostae

D) Artikulacionin radio-carpal

10. Vlerësimi kardiovaskular ka të bëjë me:

- A) Testet gjenetike
- B) Testet laboratorike
- C) Testimin muskular
- D) Testimin neurologjik

11. Simptoma tipike për një efort të shtuar gjatë rehabilitimit kardiak është:

- A) Sinkope
- B) Dhimbje abdominale
- C) Nauze
- D) Dispne persistente

12. Faktorë risku në sëmundjet arterosklerotike është:

- A) Dislipidemia
- B) Hiperaktiviteti fizik
- C) Hepatiti B
- D) Cefale

13. Pas fillimit të episodit të angina pectoris pacientët kërkojnë:

- A) Të shtojnë aktivitetin
- B) Të ndalojnë aktivitetin
- C) Të vazhdojnë aktivitetin normalisht
- D) Të kufizojë aktivitetin

14. Anguri tipik i angina pectoris shfaqet klinikisht me dhimbje:

- A) abdominale
- B) torakale
- C) retrosternale
- D) lombare

15. Mjekimi definitiv i kardiomiopative konsiston në:

- A) Transplant të zemrës
- B) Mjekimi me antiaritmikë
- C) Mjekimi me vazodilatatorë
- D) Mjekimi me diuretikë

16. Komplikacion i hipertensionit arterial mund të jetë:

- A) Sinkope
- B) Atak kardiak
- C) Haluçinacione
- D) Takikardi sinusale

17. Sa valvula ka zemra?

- A) 7

- B) 5
- C) 2
- D) 4

18. Etiologjia e valvulopative është:

- A) Kongenitale apo e fituar
- B) Traumatike
- C) Komplikacion i insufiçencës kardiake
- D) Komplikacion i kardiomiopative

19. Përgatitja preoperative në pacientet që i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale konsiston në:

- A) Gjimnastikën respiratore
- B) Sporte si: futbollin, volejbollin
- C) Ushtrime për rirforcim muskular
- D) Përdorimi i biçikletës

20. Objektive në fazën e dytë post transplantit kardiak është:

- A) Reduktimi i ankthit
- B) Përmirësimi i kapacitetit ajror
- C) Zvogëlim të kapacitetit të efortit
- D) Zvogëlim të kapacitetit aerobik

21. Insufiçenca kardiake është një patologji, e cila:

- A) prek vetëm zemrën
- B) është patologji sistemike, përveç zemrës prek edhe sisteme të tjera
- C) prek vetëm enët e gjakut
- D) prek aparatit tretës

22. Shenja klinike tipike e insufiçencës kardiake është:

- A) cianoza
- B) dhimbja e kokës
- C) nauze
- D) dispne e tipeve si: ortopne, dispne e efortit, paroksistike.

23. Dhimbja tipike në infarkt të miokardit zgjat:

- A) 10 min
- B) 30 min
- C) 20 min
- D) 5 min

24. Faktorë riskues i modifikueshëm të IAM është:

- A) Arterioskleroza
- B) Obeziteti
- C) Vaskuliti
- D) Embolia koronare

25. Parandalimi i shfaqjes së venave varikoze realizohet përmes:
- A) përdorimit të corapeve elastike
  - B) qëndrimit për një kohë të gjatë në këmbë
  - C) qëndrimit në dekubitues dorsal, me gjunjtë në ekstension
  - D) qëndrimit për një kohë të gjatë ulur
26. Rehabilitimi fizioterapeutik në afeksionet venoze nënkupton:
- A) Lëvizshmërinë pasive dhe aktive të anësive
  - B) Krioterapi
  - C) Hiperaktivitet
  - D) Sporte si vrap, hedhja e shtizës.
27. Tromboflebiti është një patologji në të cilën:
- A) Trombet shkaktojnë afeksione venoze
  - B) Trombet rrisin përmasat e tyre
  - C) Trombet shkaktojnë inflamacion në vena
  - D) Afektohen strukturat artikulare
28. Angioplastika koronare perkutane transluminale (PTC) përdoret për:
- A) Rivaskularizimin e miokardit e shkaktuar nga insufiçenca e arteries koronare
  - B) Rivaskularizimin e miokardit e shkaktuar nga stenoza e arteries koronare
  - C) Rivaskularizimin e endokardit e shkaktuar nga insufiçenca e arteries koronare
  - D) Rivaskularizimin e perikardit e shkaktuar nga stenoza e arteries koronare
29. Rehabilitimi kinetik pas angioplastikës fillon:
- A) menjëherë pas angioplastikës
  - B) pas 2-5 ditësh
  - C) pas një jave
  - D) pas një muaji
30. Objektivat e fazës post operatore pas ndërhyrjeve kardiake kanë të bëjnë me:
- A) Parandalim të ngurtësimeve të artikulacioneve përmes lëvizjeve pasive me një ritëm prej 2 herë në ditë
  - B) Informim të përgjithshëm mbi ndërhyrjen
  - C) Vlerësim të tipit të frymëmarrjes
  - D) Reduktim të ankthit
31. Faza e 3-të e rehabilitimit të IAM ka të bëjë me:
- A) Periudhën e hospitalizimit
  - B) Periudhën pas daljes nga spitali
  - C) Terapia mbajtëse për gjithë jetën
  - D) Përgatitja për ndërhyrje kardiake
32. Në infarkt akut të miokardit fizioterapia:
- A) ka kundërindikacion absolut
  - B) ka shumë rëndësi për riaftësimin e pacientit

- C) bëhet me aparatura
- D) bëhet me masazh.

33. Rehabilitimi i pacientit me infarkt miokardi zgjat:

- A) 1 muaj
- B) 6 muaj
- C) 12 muaj
- D) gjithë jetën

34. Tek pacienti me djegie deri 50% të trupit rehabilitimi fillon:

- A) pasi pacienti ka dal nga qëndra e djegje plastikës
- B) pasi është formuar cikatriceja e plotë
- C) që në ditët e para pas djegjes
- D) varet nga gjëndja e pacientit

35. Grate shtatezana duhet te bejne gjimnastike ne:

- A) tremujorin e pare
- B) tremujorin e dyte
- C) tremujorin e trete
- D) gjimnastika eshte e kunderindikuar

36. Nje seance fizioterapie te nje grua shtatzane fillon:

- A) me ushtrime respiratore
- B) me zgjatje muskulare
- C) me perforcim muskular
- D) me manjeto terapi

37. Gjate nje shtatezanie normale nuk kemi:

- A) dhimbje mesi
- B) edeme te gjymtyreve te poshtme
- C) hiperlordoze lumbare
- D) hiperlordoze cervicale

38. Pregatitjen per lindje, te nje gruaje shtatzane fizioterapisti e fillon:

- A) ne muajin e gjashte
- B) pas shtate muaj e gjysem
- C) pas muajit te tete
- D) kur nena eshte futur ne muajin e nente

39. Nje nga qellimet e fizioterapise ne grate shtatezana eshte perforcimi i muskujve:

- A) abdominal
- B) te gjymtyreve te poshteme
- C) qe mbajne shpinen drejt
- D) perineal



40. Në seancën e parë të trajtimit të një gruaje shtatezane për herë të parë është shumë e rëndësishme:
- A) shpjegimi i strukturave anatomike, funksionin fiziologjik dhe ndryshimet në shtatezani
  - B) puna në 3 kohe të muskujve perineal
  - C) Punë me muskujt rektus abdominal
  - D) Zgjatja e ishiatikeve
41. Punë me respiracionin të një gruaje shtatezane është një teknikë:
- A) relaksimi
  - B) perforcimi
  - C) zgjatjeje
  - D) është e kundershtuar
42. Të një gruaje në post-partum imediat (4-8 javë pas lindjes) objektivi kryesor i fizioterapisë konsiston në:
- A) perforcimin e muskujve abdominal
  - B) perforcimin e muskujve gluteal
  - C) edukimin dhe parandalimin e inkontinencës urinare dhe fekale
  - D) edukimi se si duhet të ushqejë foshnjën me gjë
43. Një gruaje shtatezane kur testin duhet:
- A) të bllokojë hundet
  - B) të mbyllë glotën
  - C) të fryjë barkun
  - D) të kontraktojë muskujt perineal
44. Pas një lindjeje normale, sakrumi është në pozicion:
- A) anterior
  - B) posterior
  - C) i inklinuar një anë
  - D) në pozicion neutral
45. Rehabilitimi fizioterapeutik i insuficiencës kardiake në fazën akute konsiston në:
- A) Qëndrim në dekubitues dorsal në shtrat shoqëruar me ushtrime të lehta të anësive duke ruajtur ritmet respiratore
  - B) Lëvizje lëkundese të anësive
  - C) Sporte të ndryshme
  - D) Ushtrime aktive me amplitudë të ulët

## **10. Pediatri dhe Rehabilitim në Pediatri**

1. Dhëmbët e qumështit zëvendësohen me dhëmbët e përhershëm rreth moshës:
- A) 3 - 4 vjeç
  - B) 4 - 5 vjeç
  - C) 6 - 7 vjeç
  - D) 8 - 9 vjeç

2. Quhet fëmijë prematur i linduri:
- A) para 37 javësh moshë shtatzënie
  - B) para 37 javësh moshë shtatzënie dhe me peshë nën 2500 g
  - C) pas 42 javësh moshë shtatzënie
  - D) ndërmjet 37 dhe 42 javësh moshë shtatzënie
3. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në rritje e zhvillim janë të gjithë me përjashtim të:
- A) kushteve social-ekonomike
  - B) klimes tropikale
  - C) sëmundjeve kronike pas lindjes
  - D) faktorëve gjenetikë
4. Fëmija e dyfishon peshën e lindjes në moshën:
- A) 1 vjeç
  - B) 8 muaj
  - C) 10 muaj
  - D) 5 muaj
5. Vitamina D merr pjesë në:
- A) mineralizimin e kockës
  - B) aktivitetin nervor
  - C) pjekurinë seksuale
  - D) hematopoezë
6. Fëmija e trefishon peshën e tij në moshën:
- A) 1.5 vjeç
  - B) 2 vjeç
  - C) 12 muaj
  - D) 1.8 muaj
7. Për vaksinimin sipas kalendarit të vaksinimit janë të vërteta të gjitha, me përjashtim të:
- A) Eshtë i detyrueshëm për të gjithë fëmijët
  - B) Nuk këshillohet të bëhet për fëmijët e lindur para kohe
  - C) Ndihmon në krijimin e imunitetit të fëmijës
  - D) Për aplikimin e vaksinave duhen respektuar afatet kohore sipas këtij kalendarit
8. Faktorët e brendshëm që ndikojnë në rritje e zhvillim janë të gjithë me përjashtim të:
- A) hormoneve seksuale
  - B) kushteve social-ekonomike
  - C) hormoneve të tiroides
  - D) faktorëve gjenetikë
9. Encefalopatia bilirubinike tek një fëmijë në term shfaqet kur vlera e bilirubinës serike arrin në:
- A)  $\geq 10$  mg/dl
  - B)  $\geq 15$  mg/dl

- C)  $\geq 18$  mg/dl
- D)  $\geq 20$  mg/dl

10. Për kulloshtrën janë të vërteta të gjitha, me përjashtim të:

- A) kulloshtra prodhohet nga gjendrat mamare ditët e para pas lindjes
- B) përmban shumë yndyrma e sheqerna dhe pak proteina
- C) përmban antikorpe të nënës
- D) mbron fëmijën nga infeksionet

11. Për infeksionin nga Rubeola Kongenitale janë të vërteta të gjitha me përjashtim të:

- A) prek fetusin me rrugë transplacentare
- B) shkakton vonesë në rritjen intrauterine dhe anemi tek bebi
- C) nuk kemi në përdorim asnjë mënyrë parandalimi
- D) është një nga shkaqet e prematurancës.

12. Infeksioni neonatal nuk ka të vërtetë:

- A) hipotermi
- B) hipoglicemi
- C) hipobilirubinemi
- D) ulje të frekuencës kardiake

13. Apgari është:

- A) sëmundje ngjitëse e neonatit
- B) sëmundje e sistemit kardiorespirator
- C) sistem vlerësues i shenjave jetësore të neonatit
- D) refleksi arkaik

14. Përbëjnë kundërrindikacion absolut për ushqyerjen me gji të gjitha me përjashtim të:

- A) HIV-it të nënës
- B) Insuficiencës kardiake e dekompesuar të nënës
- C) TBC aktiv të nënës
- D) përdorimit të drogave nga nëna
- E) ragadet e gjirit të nënës

15. Fëmija katërfishon peshën e lindjes në moshën:

- A) 1 vjeç
- B) 1.5 vjeç
- C) 2 vjeç
- D) 5 vjeç

16. Proteina C reaktive është e rritur në të gjitha rastet, me përjashtim të:

- A) meningit
- B) sepsis
- C) pneumoni
- D) hipoksi nga një lindje e vështirë.

17. Tetanosi neonatal ka të vërteta të gjitha, me përjashtim të:

- A) shkakton kontraktura muskulare
- B) shkakton fraktura të kockave
- C) shkakton sepsis
- D) shkakton çrregullime të frymëmarrjes

18. Për fototerapinë janë të vërteta të gjitha, me përjashtim të:

- A) vepron duke zbërthyer bilirubinën kutane
- B) ndihmon në uljen e nivelit të bilirubinës së palidhur
- C) nuk ekziston një vlerë e përcaktuar e nivelit të bilirubinës tek të gjithë neonatët për fillimin e fototerapisë
- D) përdorimi i saj nuk e parandalon shfaqjen e encefalopatisë

19. Quhet fëmijë postmatur i linduri:

- A) me peshë nën 2500 g
- B) përpara 37 javësh moshë shtatzënie
- C) pas javës 42 të shtatzënisë
- D) nga 37 në 42 javë moshë shtatzënie

20. Fëmija i moshës 2 vjeç flet rreth:

- A) 50 fjalë
- B) 100 fjalë
- C) 300 fjalë
- D) 500 fjalë

21. Infeksioni neonatal ka të gjitha shenjat klinike të mëposhtme, me përjashtim të:

- A) temperaturë e lartë
- B) rash kutan (njolla të kuqe në lëkurë)
- C) ikter
- D) hiperglicemi

22. Mekonium quhet:

- A) qumështi i ditëve të para pas lindjes
- B) një keqformim i lindur i traktit gastrointestinal
- C) një sëmundje ngjitëse e transmetuar nga nëna
- D) jashtëqitja e parë e bebit

23. Vlerësimi i Apgarit nuk përfshin:

- A) frekuencën kardiake
- B) tonusin muskular
- C) frekuencën respiratore
- D) përgjigjen ndaj ngacmimit
- E) reflexet primare

24. Shkaktojnë keqformime të lindura të gjitha, me përjashtim të:

- A) rubeola kongenitale

- B) toksoplazmoza kongenitale
- C) CMV kongenital
- D) hepatiti B kongenital

25. Mund të jenë shenja klinike të një infeksioni neonatal të gjitha, me përjashtim të:

- A) hipotermise
- B) hiperglicemise
- C) hepatosplenomegalise
- D) bombim i fontanelës
- E) rash kutan (skuqje)

26. Kern ikteri shkaktohet nga:

- A) fiksimi i bilirubinës së palidhur në bërthamat trunore
- B) fillimi i parakohshëm i ablaktacionit
- C) anemia nga mungesa e hekurit
- D) ikteri nga qumështi i gjirit

27. Ikteri tek neonati bëhet i dukshëm në lëkurë kur niveli serik i bilirubinës është:

- A) 2-4 mg/dl,
- B) 5-7 mg/dl,
- C) 8-9 mg/dl,
- D) 10 mg/dl

28. Terapia rehidruese orale është trajtim i zgjedhur për të gjithë fëmijët e dehidruar, me përjashtim:

- A) të vjella dhe temperaturë e lartë,
- B) koma ose shok
- C) shigeloze
- D) helmim ushqimor
- E) elasticitet i ulur i lëkurës

29. Favorizojnë malnutricionin të gjitha, me përjashtim:

- A) infeksionet kronike,
- B) përdorimi pa kriter i antibiotikëve,
- C) rrezatim i tepruar nga rrezet e diellit,
- D) kushtet e këqija social-ekonomike,
- E) prematuriteti

30. Mjekimi i zgjedhur në Giardiazë është:

- A) amikacina,
- B) mebendazoli,
- C) piperazina,
- D) metronidazoli (Flagyl).

31. Ndërlikimi më i shpeshtë i Salmonelozës është:

- A) prolapsi rektal

- B) anemia
- C) dehidrimet e tipeve të ndryshme
- D) meningiti

32. Cili nga ekzaminimet e mëposhtme nuk ka vlerë në shigelozë?

- A) Koprokultura,
- B) Hemokultura,
- C) Kërkimi për pus e gjak në feçe,
- D) Urinë komplet

33. Cila nga masat e mëposhtme duhet marrë në një fëmijë me shok anafilaktik të rëndë?

- A) Veshja e tij që te mos kete ftohte,
- B) Ushqyerja.
- C) Rehidrimi
- D) Përdorimi i adrenalinës

34. Në dehidrimin hiperton vuan më shumë:

- A) sistemi kardiovaskular
- B) sistemi nervor
- C) trakti tretës
- D) sistemi hemopoetik

35. Doza e Acetaminofenit (Paracetamol) në fëmijë është:

- A) 1 mg/kg për çdo marrje,
- B) 2 mg/kg për çdo marrje,
- C) 5 mg/kg për çdo marrje,
- D) 15 mg/kg për çdo marrje.

36. Infiltrati eozinofilik Löffler në pulmone mund të haset në:

- A) enterobiozë (oksiuriasë)
- B) teniazë
- C) askaridozë
- D) sepsis nga Salmonella

37. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për stenozen hipertrofike të pilorit?

- A) të vjella që në lindje,
- B) ekziston një interval pa shenja klinike ndërmjet lindjes dhe çrregullimeve të para,
- C) ka prani të bilës në të vjella,
- D) ka humbje të oreksit,
- E) ka diarre

38. Shkaktojnë çrregullime malabsorbitive të gjitha, me përjashtim:

- A) alergjia nga proteinat e qumështit të lopës,
- B) dermatiti atopik,
- C) malnutricioni proteino-kalorik,
- D) lambliaza,

E) Kwashiorkor-i

39. Sa është sasia e Tresolit që përdoret për rehidrim oral në dehidrimin e lehtë?

- A) 10 mg/kg peshë,
- B) 20 mg/kg peshë,
- C) 50 mg/kg peshë,
- D) 100 mg/kg peshë.

40. Tetania në fëmijët e vegjël është pasojë e:

- A) rritjes së glicemisë,
- B) uljes së kalciumit të jonizuar në gjak,
- C) uljes së glicemisë,
- D) rritjes së kalcemisë.

41. Shkaku më i shpeshtë i urtikarieve është:

- A) alergjia ushqimore,
- B) infeksionet virale,
- C) alergjia medikamentoze,
- D) idiopatik- i pa njohur.

42. Prania e leukociteve në feçe vihet re në diarrenë nga:

- A) shigella
- B) viruset
- C) gabimet në ushqyerje
- D) helmimet ushqimore

43. Provokimi i të vjellave ka kundërindikacion absolut në helmimet:

- A) ushqimore,
- B) nga marrja e lëndëve kaustike
- C) nga paracetamoli,
- D) nga valiumi.

44. Forma e dehidrimit (i lehtë-i mesëm-i rëndë) tek fëmija vlerësohet me të gjitha, me përjashtim të?

- A) matja e presionit arterial,
- B) thellimi i syve,
- C) dhimbja e kokës,
- D) niveli i fontanelës së madhe.

45. Toksina difteritike parapëlqen:

- A) Indin renal
- B) Timusin
- C) Tiroiden
- D) Miokardin

46. Teniat janë:

- A) viruse
- B) baktere
- C) krimba
- D) myke

47. Shenja Trousseau lidhet me:

- A) hipokalceminë
- B) hipovitaminozën A
- C) hipovitaminozën K
- D) shokun anafilaktik

48. Doza e Adrenalinës subkutan për trajtimin e shokut anafilaktik është:

- A) 0.1 mg për çdo 10 kg peshë,
- B) 0.5 mg për çdo 10 kg peshë,
- C) 1 mg për çdo 10 kg peshë,
- D) 10 mg për çdo 10 kg peshë

49. Vlerësimi i moshës kockore bëhet më mirë me radiografinë e:

- A) gjurit
- B) artikulationit radiokarpal
- C) kavaljes
- D) bërrylit

50. Për hipotiroidizmin kongenital janë karakteristike të gjitha, me përjashtim:

- A) fontanela anteriore e posteriore shumë të mëdha
- B) vonesë në pjekurinë skeletike
- C) ikter
- D) hernie umbilikale

51. Një fëmije quhet prematurë kur:

- A) ka lindur para javës së 37 të shtatëzanisë
- B) ka lindur me lindje cezariane
- C) nëna është në moshë të madhe
- D) është femija i parë

52. Fëmijët që lindin në javën e 32 të shtatëzanisë:

- A) kanë peshë të madhe trupore
- B) lindin pa flokë
- C) janë vetëm vajza
- D) organet janë të pa zhvilluara plotësisht

53. Paraliza obstetrikale e të porsalindurit nënkupton:

- A) Prekje të pleksusit brakial
- B) Zvogëlim të sensibilitetit në gjysmën e trupit
- C) Paralizë të gjymtyrëve të poshtme
- D) Dobësi muskulare në gjymtyrët e poshtme



54. Një fëmijë distonik karakterizohet nga:
- A) ndryshime të medha të tonusit muskular
  - B) ndryshime në gjatësi të gjymtyrëve të poshtme
  - C) ç'rregullime të sensibilitetit
  - D) vështirësi në komunikim
55. Qëllimi kryesor i trajtimit fizioterapeutik të fëmijës me prekje të pleksusit brakial është:
- A) funksionaliteti në ecje
  - B) përmirësimi i ekuilibrit në statik dhe dinamik
  - C) funksionaliteti i gjymtyrës së sipërme të prekur
  - D) përforcimi i muskujve të trungut
56. Në deformimin e shputës "pied bot equino varus" kemi:
- A) Fleksion dorsal të theksuar dhe ekstension të gishtave
  - B) Fleksion plantar, inversion dhe aduksion të parashputës
  - C) Sheshim të harkut intern të këmbës
  - D) Ana e prekur ka numër më të madh se tjetra
57. Në një fëmijë spastik, qëllimi kryesor i trajtimit është:
- A) Rritja e tonusit muskular
  - B) Zvogëlimi i tonusit muskular
  - C) Përforcimi muskular
  - D) Puna me ekuilibrin dhe propioceptionin
58. Në rastin e një tortikolis kongenital, mund të kemi:
- A) Deformim të shputës ekuino varus
  - B) Spasticitet
  - C) Prapambetje mendore
  - D) Prezencën e plagiocefalisë
59. Një nga rolet e fizioterapistit në një fëmijë me tortikolis kongenital është:
- A) të këshillojë prindërit për mënyrën e mbajtjes dhe kujdesjen e fëmijës
  - B) të ndërhyjë në politikën qeverisëse
  - C) ta shoqërojë fëmijën çdo ditë në shtëpi
  - D) të kërkojë përkrahje sociale
60. Testi më i shpeshtë që realizohet në fëmijët me luksacion kongenital të kokso-femoralit është:
- A) Testi i "Ortolanit"
  - B) Shkalla "Aushworth"
  - C) Testi "Up and GO"
  - D) Testi i "14 metrave"
61. Në rastin e një luksacioni kongenital të kokso-femoralit, "pozicioni i stabilitetit" ose pozicioni i korrigjimit është:
- A) Ektension

- B) Fleksion; abduksion; rrotacion ekstern
- C) Rrotacion intern
- D) Fleksion i gjurit

62. Hipotonia është:

- A) ulje të tonusit muskular
- B) rritje të tonusit muskular
- C) lëvizje të pavullnetshme
- D) vështirësi respiratore

63. Gjatë një seance të fizioterapisë, stimulimi me lodra i fëmijës bëhet:

- A) në kuadër të terapisë
- B) që fëmija të mos qaj
- C) për të kënaqur prindërit
- D) Nuk duhet të bëhet

64. Një fëmijë hiperaktiv prezanton:

- A) Vështirësi në ecje
- B) Defiçenc auditive
- C) Defiçit të vëmendjes dhe impulsivitet motorik
- D) Probleme të aparatit tretës

65. Në një rast me Spina Bifida mielomeningocele:

- A) Shpesh është asimptomatike
- B) Nuk ka nevojë për trajtim, vetëm mbikqyrje
- C) Nuk prezanton probleme neurologjike
- D) Prezanton probleme neurologjike të rënda

66. Thithja e kalciumit në zorrë varet nga:

- A) hormonet e tiroides
- B) insulina
- C) vitamina D
- D) përqëndrimi në gjak i vitaminës C
- E) testosteroni

67. Dermatiti atopik:

- A) është sëmundje me predipozitë të qartë trashëguese
- B) lidhet me praninë e parazitëve intestinalë
- C) prek kryesisht adoleshentët
- D) mjekohet me barna antimykotikë

68. Njëra nga shenjat e mëposhtme dëshmon për stenoze hipertrofike të pilorit:

- A) të vjella biliare
- B) anoreksia
- C) diarrea
- D) të vjella ushqimore pas ushqyerjes.

69. Çfarë vë në dukje koprokultura?

- A) viruset
- B) myket
- C) parazitet
- D) protozoarët

70. Kwashiorkor:

- A) është sëmundje infektive bakteriale,
- B) shkaktohet nga marrja e pamjaftueshme e yndyrnave,
- C) shkaktohet nga krimbat e rrumbullakët intestinalë,
- D) shkaktohet nga marrja e pamjaftueshme e proteinave, e shoqëruar me marrje disi të mjaftueshme të kalorive

71. Në rakit është karakteristike:

- A) hipokalcemia
- B) proteinuria
- C) anemia
- D) hiperglicemia

72. Sa është sasia e likideve për mbushjen e shtratit vaskular në dehidrimin e mesëm?

- A) 10 ml/kg peshë
- B) 20 ml/kg peshë
- C) 50 ml/kg peshë
- D) 90 ml/kg peshë

73. Hipotiroidizmi kongenital mjekohet me:

- A) hormonin e rritjes
- B) L-tyroksine
- C) kortizonikë
- D) insulinë

74. Për stnozën hipertrofike të pilorit janë të vërteta të gjitha, përveç:

- A) është më e shpeshtë në meshkuj,
- B) fillimisht të vjellat janë gojë-gojë, pastaj presioni shtohet,
- C) të vjellat janë biliare,
- D) rritja e fëmijës dëmtohet nga kjo patologji, zakonisht shfaqet në muajt e parë të jetës.

75. Cili nga çrregullimet e mëposhtme është i pranishëm në shokun hipovolemik?

- A) edema të shprehura
- B) hiperglicemi
- C) hiperalbuminemi
- D) acidozë metabolike.

76. Janë shenja të rakitit të gjitha, me përjashtim të:

- A) kraniotabes
- B) ngadalësim i rritjes

- C) sulkusi i Harrisonit
- D) skorbuti
- E) tespiet rakitike

77. Çrregullimet alergjike mund të mjekohen me sukses me të gjitha mënyrat e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) mënjanimin të kontaktit me alergenin
- B) mjekimit adekuat farmakologjik [adrenalinë, anihistaminikë]
- C) përdorimit të barnave antimikrobike
- D) përdorimit të bronkodilatatorëve

78. Karboni aktiv përdoret për trajtimin e:

- A) intoksikacioneve në fëmijë
- B) hipokalcemisë
- C) diarresë dhe/ose të vjellave
- D) hipokalcemisë

79. Sindromi Reye lidhet me përdorimin e:

- A) aspirinës
- B) aminofilinës
- C) amfetaminës
- D) antibiotikëve

80. Doza e paracetamolit për uljen e temperaturës në fëmijë është:

- A) 5 mg/kg në një marrje
- B) 10 mg/kg në një marrje
- C) 15 mg/kg në një marrje
- D) 20 mg/kg në një marrje

81. Serumi antidifteritik:

- A) Lidh toksinën që qarkullon në gjak
- B) Shkrin membranat e formuara në fyt
- C) Pengon shumimin e mikroorganizmit
- D) Përdoret si profilaksi kundër difterisë

82. Për paralizat e poliomielitit njëri nga pohimet nuk është i vërtetë:

- A) Janë flakside
- B) Janë simetrike
- C) Janë të përherëshme
- D) Janë proksimale

83. Paraliza e nervit glosofaringeal, me dalje të lëngjeve nga hunda, mund të vihet re në:

- A) Rubeolë
- B) Sinuzit
- C) Difteri
- D) Askaridozë

84. Ekzantema që shfaqet edhe në lëkurën me flokë flet për:

- A) Rubeolë
- B) Varicelë
- C) Fruth
- D) Skarlatinë

85. Rashi kutan makulo-papulo-vezikular, i shoqëruar me temperaturë të lartë dhe prurit flet për:

- A) Rubeolë
- B) Varicelë
- C) Fruth
- D) Skarlatinë

86. Janë komplikacione të varicelës të gjitha, me përjashtim të:

- A) Qelbëzimi i elementeve kutane
- B) Sindromi Reye
- C) Glomerulonefriti
- D) Herpes Zoster

87. Fenobarbitali (Luminali) përdoret për trajtimin e:

- A) Giardia lamblias
- B) Laringitit akut
- C) Statusit konvulsiv
- D) Skarlatinës

88. Në varicelë nuk duhen përdorur:

- A) Antihistaminikët
- B) Aspirina
- C) Antibiotikët
- D) Solucionet rehidruese
- E) Paracetamoli

89. Shenja madhore e glomerulonefritit akut është:

- A) Proteinuria
- B) Hematuria
- C) Hipertensioni arterial
- D) Anemia

90. Nuk është e dobishme të përdoren për pertusin:

- A) Oksigjenoterapi
- B) Diazepam
- C) Inhalacion me bronkodilatatorë
- D) Antibiotiket

91. Gjuha si manaferra të kuqe është karakteristike e:

- A) Rubeolës
- B) Parotitit

- C) Skarlatinës
- D) Fruthit

92. Njëra nga shenjat e mëposhtme nuk bën pjesë në kriteret madhore të Ethes Reumatizmale Akute:

- A) Carditis
- B) Poliarthritis
- C) Bradikardia
- D) Chorea minor

93. Shkakton anemi ferriprive:

- A) Hemofilia
- B) Talasemia
- C) Papajtueshmëria nga faktori Rh
- D) Nënushqyerja

94. Cila nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristike e Sindromit Nefrotik Idiopatik?

- A) Hipoproteinemia
- B) Edema
- C) Poliuria
- D) Proteinuria

95. Në cilën moshë hasen më shpesh konvulsionet febrile?

- A) Tek i porsalinduri
- B) Nga muaji i parë në muajin e pestë të jetë
- C) 6 muaj - 5 vjeç
- D) Nga 6 në 12 vjeç

96. Bronkioliti nuk ka të vërtetë:

- A) Takipne
- B) Cianoze
- C) Tirazh
- D) Dispne inspiratore

97. Shoku anafilaktik nuk trajtohet me:

- A) Adrenalinë
- B) Inhalacion me bronkodilatatorë
- C) Kortizonikë
- D) Antibiotike

98. Diagnoza etiologjike e faringotonsilitit streptokoksik?-hemolitik të grupit A bëhet me:

- A) Hemokulturë
- B) Kulturë fytë
- C) Urokulturë
- D) Gjak komplet

99. Karakteristikat klinike të infeksionit nga Hepatiti A janë si më poshtë, me përjashtim:

- A) Periudha e inkubacionit është 15-50 ditë
- B) Klinika ka manifestime të shumta ekstrahepatike
- C) Transmetimi është fekal-oral
- D) Infeksioni manifestohet me rritje të transaminazave dhe të bilirubinës

## 11. E Përgjithshme Paraklinike

1. Cila nga brinjët e mëposhtme nuk është atipike?

- A) E parë
- B) E dytë
- C) E tretë
- D) E dymbëdhjetë

2. Mbledhja e muskujve quhet:

- A) Adduksion
- B) Abduksion
- C) Flexion
- D) Extension

3. Pelvisi formohet nga kockat e mëposhtme me përjashtim të:

- A) Oss coxae
- B) Oss sacrum
- C) Oss coccygeum
- D) Vertebra lumbare e pestë

4. Skapula nuk ka Fose:

- A) glenoidale
- B) subskapulare
- C) supraspinale
- D) infraspinale

5. Humerusi nuk ka Fose:

- A) olekrani
- B) kapitis
- C) radiale
- D) koroide

6. Nuk i takon kafkës elemeti:

- A) Calvaria
- B) Promontorium
- C) Glabella
- D) Clivus

7. Procesi zigomatik mungon tek:

- A) Kocka frontale

- B) Kocka zigomatike
- C) Kocka temporal
- D) Maxilla

8. Atlasi nuk ka:

- A) procese artikulare
- B) Foramen transversal
- C) Fovea dentis
- D) dy tuberkulume

9. Proces i skeletit torakal është:

- A) stiloideus
- B) xipfoideus
- C) mamillaris
- D) zygomatikus

10. Tek sacrum nuk gjejmë:

- A) Facies artikularis
- B) Linea transversal
- C) Cornua sacralia
- D) Spina sacralis

11. Cili nga muskujt e mëposhtëm nuk fillon me dy koka?

- A) Rectus femoris
- B) Digastrikus
- C) Pronator teres
- D) Gastrocnemius

12. Artikulacioni temporomandibular është i tipit:

- A) Cilindrik
- B) Sferik
- C) Elipsoid
- D) Enarthrosis

13. Muskujt pektoralë i takojnë:

- A) Abdomenit
- B) Pelvisit
- C) Shpinës
- D) Toraksit

14. Muskujt e mimikës:

- A) Lëvizin manibulën
- B) Inervohen nga n. Facial
- C) Kanë inervime të ndryshme nga njëra -tjetra
- D) Kanë dy pika fiksime në kocka



15. M.deltoideus fiksohet në:

- A) Oss scapula
- B) Oss Clavikula
- C) Oss humerusi
- D) Vertebren e tretë

16. Artikulacioni genu realizohet ndërmjet:

- A) Femurit, tibies, fibules
- B) Femurit, tibies, patelles
- C) Femurit dhe tibies
- D) Femurit fibula dhe patella

17. Në lidhjet e kafkës mbizotërojnë:

- A) Artikulacionet
- B) Suturat
- C) Ligamentet
- D) Sinkondrozat

18. Në cilin prej proceseve, qelizat shpenzojnë rreth 40% të energjisë së tyre ditore?

- A) Ne transportin aktiv
- B) Ne endocitozë
- C) Ne exocytosë
- D) Ne difuzion të lehtësuar

19. Me cilin lloj procesi transportohet glukozja prej proteinës mbartëse nga një zonë me përqendrim më të lartë drejt një zone me përqendrim më të ulët?

- A) Me transportin aktiv
- B) Endocitozën
- C) Difuzionin e lehtësuar
- D) Difuzionin e thjeshtë

20. Pjesa e sistemit nervor që konsiderohet e pavullneshme është:

- A) SN somatic
- B) SN autonom
- C) SN sensor
- D) SN motor

21. Invaginimet e sarkolemës që formojnë zgjatime në formë gishtërinjsh, që depërtojnë në brendësi të fibrës muskulare quhen:

- A) retikulum sarkoplazmik
- B) retikulum endoplazmatik
- C) tubujt T
- D) filamentet e aktines

22. Segmenti i miofibrilit i quajtur sarkomer, gjendet midis:

- A) dy linjave Z

- B) dy bandave A
- C) dy zonave H
- D) dy aktinave

23. Në një sinaps neuro-muskular, neuroni e çliron neurotransmetuesin në:

- A) pllakën motore
- B) citoplazmën e qelizës muskulare
- C) cisternat terminale
- D) hapësirën sinaptike

24. Një njësi motore përbëhet nga:

- A) të gjitha fibrat muskulare brenda një muskuli të caktuar
- B) nga një neuron motor dhe fibrat muskulare që ai kontrakton
- C) të gjitha neuronet që inervojnë një pjesë të caktuar të trupit
- D) një muskul dhe një nerv

25. Të gjitha më poshtë janë shenja të inflamacionit përveç:

- A) dhimbjes
- B) skuqjes
- C) temperatures
- D) hipertensionit arterial

26. Një nga molekulat e mëposhtme bën të mundur që muskuli të sigurojë energjinë e nevojshme për kontraksion duke gjeneruar ATP prej ADP. Cila është ajo?

- A) Creatinë fosfati
- B) Fosfokinaza
- C) Acetilkolinesteraza
- D) Katalaza

27. Cila nga qelizat e mëposhtme prodhon antikorpe?

- A) Limfocitet T
- B) Limfocitet B
- C) Monocitet
- D) Fagocitet

28. Si quhen degëzimet nervore të cilat përcjellin impulsin drejt trupit të neuronit?

- A) Aksone
- B) Dendrite
- C) Trupa Nissl
- D) Neurofibrile

29. Sistemi nervor autonom inervon të gjitha më poshtë përveç:

- A) muskulit kardiak
- B) gjendrave egzokrine
- C) muskulit skeletik
- D) traktit tretës

30. Zgjidhni thënien e pasaktë ndër të mëposhtmet lidhur me përçimin e impulsit nevor:
- A) Përçimi i impulsit nevor bëhet sipas ligjit gjithcka ose asgjë
  - B) Një stimulim me intensitet më të lartë shkakton impulse më të fuqishme
  - C) Përçimi i impulsit në fibrat e mielinizuara bëhet me kërcim nga një nyje Ranvier në tjetrën
  - D) Arritja e potencialit të veprimit rrit përshkueshmërinë e membranësaksonale
31. Neurotransmetuesit të cilët rrisin permeabilitetin e membranës post sinaptike për jonet Na, dhe potencojnë impulsin nevor quhen neurotransmetues:
- A) inhibitorë
  - B) eksitues
  - C) aktive
  - D) neutral
32. Pjesa fillestare e harkut reflektor është:
- A) interneuroni
  - B) fijet efektore
  - C) receptoëet ndijësor
  - D) neuroni motor
33. Aktiviteti elektrik i muskulit vlerësohet me:
- A) EEG
  - B) EMG
  - C) ECG
  - D) MRI
34. Cili është rajoni i retinës që përgjigjet për mprehtësinë e pamjes?
- A) Sclera
  - B) Lëngu qelqor
  - C) Fovea centralis
  - D) Disku optic
35. Hormonet e mëposhtme çlirohen nga antehipofiza, përveç:
- A) FSH
  - B) TSH
  - C) ACTH
  - D) HAD
36. Hormoni i prodhuar në kortexin e gjendrës mbiveshkore që vepron në veshkë duke mbajtur Na e duke eliminuar K, dhe që indirekt ndikon në ruajtjen e presionit arterial është:
- A) Aldosteroni
  - B) Epinefrina
  - C) Kortizoli
  - D) Adrenalina
37. Rritja e nivelit të hormoneve të tiroides në gjak jep efektet e mëposhtme, përveç:

- A) rënie në peshë
- B) rritje të metabolizmit bazal
- C) rritje të debitit kardiak
- D) rënie të metabolizmit të karbohidrateve

38. Cila pjesë (element) i eritrocitit mund të riciklohet në palcën e kockave për prodhimin e eritrociteve të reja?

- A) Globina
- B) I gjithë eritrociti
- C) Biliverdina
- D) Hekuri

39. Cili nga përbërësit ushqimor është më i rëndësishëm për prodhimin e eritrociteve?

- A) Ca
- B) Na
- C) proteinat
- D) vitamina B12 dhe acid Folik

40. Një person që ka bërë infarkt të muskulit të zemrës, probablisht ka një bllokim të:

- A) A. pulmonare
- B) V. cava
- C) Vv. coronare
- D) A. coronare

41. Valvulat atrio ventrikulare (A-V) mbyllen gjatë ciklit kardiak kur:

- A) pace-makeri dërgon një impuls
- B) presioni brenda atriumeve është më i madh se presioni brenda ventrikujve
- C) ventrikujt kontrahohen
- D) presioni në aortë është më i madh se VM

42. Kompleksi QRS në ECG tregon:

- A) depolarizim të atriumeve
- B) depolarizim të ventrikujve para kontraksionit
- C) repolarizim të ventrikujve
- D) zemren në qetësi

43. Mëlçia në digjestion prodhon:

- A) enzima digjестive
- B) lëndë alkaline për të neutralizuar aciditetin e stomakut
- C) bilë për të emulguar yndyrnat në zorrën e hollë
- D) substanca që ndihmojnë zorrën e trashë në absorbimin e ujit

44. Çfarë e inicion reflexin e gëlltitjes?

- A) Frika nga gëlltitja
- B) Gjuha që vërtitet në gojë
- C) Receptorët sensorë që ndiejnë ushqimin në farings

D) Receptorët e shijes

45. Receptorët e dëgjimit vendosen në:

- A) kanalet semicirkulare
- B) koklea
- C) sakula
- D) vestibule

46. Cilat qeliza të stomakut sekretojnë faktorin intrinsek?

- A) Te mukozës
- B) Parietale
- C) Peptike
- D) G

47. Cila nga të mëposhtmet nuk është përbërje e lëngut pankreatik?

- A) Kimotripsina
- B) Amilaza
- C) Bikarbonatet
- D) Acidi klorhidrik

48. Lipoproteina që ul tensionin sipërfaqësor të alveolave dhe i bën ato të mos kolabohen quhet:

- A) Fosfolipid
- B) Lipoproteinë alveolare
- C) Surfactant
- D) Tensinogjen

49. Sasia maksimale e ajrit që një person mund të expirojë pas frymëmarrjes më të thellë të mundshme është:

- A) kapaciteti pulmonar total
- B) vëllimi expirator rezervë
- C) vëllimi residual
- D) vëllimi rezervë inspirator

50. Imuniteti qelizor sigurohet nga:

- A) A.makrofagët
- B) Bazofilet
- C) Qelizat T
- D) Qelizat B

51. Oksigjeni transportohet në gjak kryesisht si:

- A) O<sub>2</sub> i tretur në plazëm
- B) deoksihemoglobinë
- C) oksihemoglobinë
- D) karbaminëhemoglobinë

52. Cili nga të mëposhtmit nuk është funksion i veshkave?

- A) Zbërthen lëndët ushqimore të ardhura me gjakun
- B) Ndihmon në kontrollin e prodhimit të eritrociteve
- C) Ndihmon në rregullimin e p. arterial
- D) Rregullon përberjen, vëllimin, pH e lëngjeve të organizmit

53. Shendeti sipas teorisë Bio-Mjekësore është:

- A) Mireqenie Shpirtërore
- B) Mireqenie Fizike
- C) Mungesë e sëmundjes
- D) Mireqenie mendore

54. Shendeti sipas OBSH është:

